

Publikuar nga:

Enti Rregullator i Ujit (ERRU)
Rr. "VIKTOR EFTIMIU"
Ndërtesa 1, Kati IV
Njësia Administrative Nr.5, 1022
Tiranë, Shqipëri

E-mail: public@erru.al

Tel. : 00355 4 2258046

http: www.erru.al

© Enti Rregullator i Ujit (ERRU)

Janar 2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

RAPORTI VJETOR 2018

**VEPRIMTARIA E ENTIT RREGULLATOR
TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
DHE
GJENDJA NË SEKTORIN UJËSJELLËS KANALIZIME**

JANAR, 2019

PËRMBAJTJA

Shkurtime	2
Parathënie	3
Përmbledhje	5
1 Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator të Ujit	11
1.1 Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë	11
1.2 Detyrime ndaj Rekomandimeve të “Progresraportit të BE-së për Shqipërinë	12
1.3 Struktura Organizative e ERRU-së	12
1.4 Veprimtaria Rregullatore dhe Monitoruese	13
1.4.1 Licencimi i Operatorëve UK	13
1.4.2 Tarifat dhe Procesi Tarifor	15
1.4.3 Statusi i Ankimeve Gjyqësore	19
1.4.4 Inspektimet	21
1.4.5 Trajtimi i Ankesave të Konsumatorëve	23
1.4.6 Monitorimi i Performancës së Sektorit dhe Shoqërive UK.....	25
1.4.7 Përmirësimi i Standardeve në Sektorin UK Nëpërmjet Instrumenteve Rregullatore	26
1.5 Bashkëpunimi dhe Marrëdhëniet Ndërinstitucionale të ERRU-së.....	27
1.5.1 Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare	27
1.5.2 Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare	29
1.6 Transparenca dhe Marrëdhëniet e ERRU-së me Publikun dhe Median	32
1.7 Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së.....	32
1.7.1 Të Ardhurat	32
1.7.2 Shpenzimet Operative	34
2 Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për Vitin 2018	36
3 Niveli i Zbatueshmërisë së Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura nga Ekzekutivi	42
4 Gjendja në Sektorin e Ujësjellës Kanalizime	43
4.1 Gjendja e Performancës së Sektorit UK për Vitin 2018	43
4.2 Situata në Zbatim të Reformës në Sektorin e Ujit	49
5 Objektivat dhe Planet e Veprimit të Punës së ERRU-së dhe Sektorit të Ujit për Vitin 2019	51
6 Rekomandime për Përmirësimin e Performancës së ERRU-së dhe për Sektorin e Ujit 52	
Aneksi 1 - Aplikimet e shoqërive dhe situata e licencimit për vitin 2018.....	53
Aneksi 2 - Shoqëri që kanë aplikuar në vitin 2017 dhe janë miratuar në vitin 2018.....	55
Aneksi 3 - Aplikimet për ndryshimin e tarifave në vitin 2018.....	56
Aneksi 4 - Vlera e faturës mujore (me TVSH) për klientët familjarë Viti 2018	57
Aneksi 6 - Shoqëritë e riorganizuar dhe të licencuara sipas reformës	58

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura
UK	Ujësjetllës Kanalizime
U	Ujësjetllës
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
KM	Këshilli i Ministrave
SHA	Shoqëri Aksionere
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
AKUM	Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmark
SHUKALB	Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë
WAREG	Shoqata e Rregullatorëve të Ujit të Evropës
NER	Rrjeti i Rregullatorëve Ekonomik
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
TKP	Treguesit Kryesorë të Performancës
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
OM	Kosto Operative dhe Mirëmbajtjeje
BE	Bashkimi Evropian
KE	Komisioni Evropian
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit

Parathënie

Raporti Vjetor 2018 paraqet aktivitetin dhe performancën e Entit Rregullator të Sektorit Ujësjellës Kanalizime në përmbushje të objektivave të tij që shprehen në veçanti në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2018.

Raporti paraqet gjithashtu edhe zhvillimet kryesore në sektorin ujësjellës kanalizime në Shqipëri, tendencat, performancat, si dhe jep rekomandime për përmirësimin e performancës së vet.

ERRU zhvillon që prej 20 vitesh aktivitetin si institucion i pavarur për rregullimin e sektorit të ujësjellës kanalizimeve duke përballuar sfida jo të vogla për forcimin e këtij statusi. Gjithnjë në fokus të institucionit është rritja e kapaciteteve në nivele bashkëkohore në mënyrë që me kontributin e tij të shërbejë si promotor për përmirësimin e performancës së këtij sektori jetik, dhe veçanërisht të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve dhe të përballueshme financiarisht. Në këtë kontekst, ERRU bën përpjekje maksimale për krijimin e një mjedisi rregullator profesional, ligjor dhe transparent për publikun.

Gjatë gjithë aktivitetit të vet ERRU ka mbështetur politikëbërësit në reformat e herëpashershme në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, por si njohës i mirë i problematikave të sektorit ka dhënë dhe jep vazhdimisht kontributin e vet me rekomandime për politika të suksesshme në drejtim të rritjes së performancës së sektorit.

Viti 2018 ka qenë vit i vazhdimësisë së reformës në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, gjë e cila ka sjellë një shtim të angazhimit të ERRU-së për të përballuar fluksin e madh të kërkesave për licencim dhe për tarifa të reja për shoqëritë e reja të krijuara dhe të ristrukturuara si rezultat i reformës administrative. Kështu, gjatë këtij viti ERRU ka licencuar 25 shoqëri të reja, si dhe ka analizuar dhe aprovuar propozimet për tarifa të reja për 8 shoqëri UK.

Krahas përballimit të një punë mjaft voluminoze, ERRU ka bërë përpjekjet maksimale edhe për ngritjen e cilësisë së punës ndaj kërkesave të licencimit të shoqërive UK, si dhe për një vlerësim dhe analizë sa më të saktë dhe të plotë të të gjithë propozimeve për nivel të ri tarifor.

Në drejtim të licencimit janë forcuar kërkesat ndaj formimit profesional të stafit të shoqërive UK, dhe veçanërisht të marrjes së Akt Miratimit Higjenu Sanitar, për të cilën ERRU po luan një rol mjaft aktiv të vendosjes në baza të drejta praktikisht të realizueshme të kërkesave për marrjen e saj.

ERRU ka përmirësuar mjaft punën në drejtim të analizave dhe të një vendimmarrjeje të drejtë për tarifën e reja të propozuara nga shoqëritë UK, bazuar në logjikën e një plani biznesi që së shpejti do të bëhet kërkesë ligjore e aplikimeve për tarifa të reja. Shoqëritë UK, gjithnjë e më shumë, duhet të japin informacione të sakta e të detajuara në lidhje me kostot e shpenzimeve dhe justifikimin e tyre, si dhe të rrisin përpjekjet e tyre për shtimin e të ardhurave duke eliminuar lidhjet e paligjshme dhe rritur normën e arkëtimit.

Në këtë drejtim, gjatë vitit 2018, ERRU ka përfunduar draftin e një instrumenti rregullator mjaft të rëndësishëm, si “Metodologjia e Vendosijes së Tarifave” në të cilën përmirësohet procedura dhe mënyra e analizës për tarifën e propozuara në bazën e realitetit të sektorit UK në vendin tonë, si dhe futjen e praktikave më të mira Europiane në këtë drejtim.

Një instrument tjetër i hartuar gjatë këtij viti është edhe “Rregullorja për Organizimin e Seancës Dëgjimore me Publikun” e cila reflekton si kërkesë bazë për shoqëritë UK përgatitjen e një model prezantimi që duhet të përmbajë në mënyrë të përmbledhur dhe lehtësisht të kuptueshme nga publiku informacionin që shoqëria duhet të prezantojë në justifikim të tarifave të reja të propozuara. Për ngritjen profesionale të stafit të institucionit dhe reflektimin e praktikave më të mira bashkëkohore gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj, ERRU vlerëson mjaft ndërtimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet partnere të rajonit dhe të Europës duke qenë proaktiv në diskutime dhe duke dhënë gjithashtu kontributin dhe eksperiencën veçanërisht si pjesë e task forcave që krijohen për studime dhe raporte për çështje të ndryshme të aktiviteteve të rregullatorëve ekonomikë.

Baza e këtyre shkëmbimeve mbeten bashkëpunimi i frytshëm me WAREG (Shoqata Europiane e Rregullatorëve të Ujit), ku ERRU është anëtare me të drejta të plota, Programi i Danubit financiar nga Banka Botërore, IWA (Shoqata Ndërkombëtare e Ujit), si dhe marrëdhëniet dypalëshe me rregullatorët në rajon, si Kosova, Maqedonia, Mal i Zi dhe ato të Europës ku më aktive janë bashkëpunimet me rregullatorët e Italisë e Skocisë.

Në përmbushje të detyrimit ligjor të ERRU-së për monitorimin e sektorit UK, ky Raport jep edhe një pasqyrim të situatës aktuale të sektorit. Vlerat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2018 paraqesin një përmirësim të lehtë të situatës ekonomike të sektorit që argumentohet me një angazhim në rritje të stafit drejtues të shoqërive UK në intensifikim të reformës në sektorin e ujësjellës kanalizimeve që ka ndërmarrë qeveria qendrore.

Krahas analizës së situatës dhe të treguesve kryesorë të performancës së sektorit, jepen dhe rekomandimet përkatëse për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të ujit në përmirësim të performancës së tij, sidomos për atë të vazhdimësisë së reformës në sektorin UK.

ERRU, në përmbushje të detyrimeve ligjore të saj kundrejt sektorit UK dhe konsumatorëve, do të vazhdojë angazhimin maksimal për të rritur dhe forcuar pavarësinë, transparencën, profesionalizmin, bashkëpunimin ndër institucional brenda dhe jashtë vendit në mënyrë të tillë që me autoritetin e vet rregullator të krijojë ekuilibrin e duhur midis ofruesve të shërbimit, politikëbërësve dhe konsumatorit.

Komisioni Kombëtar Rregullator

Përmbledhje

Raporti Vjetor 2018 i Aktivitetit të ERRU-së instrument informimi dhe transparence

Hartimi dhe publikimi i Raportit Vjetor 2018 të aktivitetit të ERRU-së përbën një detyrim ligjor me qëllim informimin dhe transparencën ndaj Kuvendit të Shqipërisë, Kryeministrit, si dhe institucioneve dhe aktorëve të tjerë që lidhen me sektorin e ujit për aktivitetin e ERRU-së.

Misioni i ERRU-së është "*Të sigurojë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që operatorët e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve ti ofrojnë ato me cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe të jenë financiarisht të qëndrueshme*".

Raporti përcakton në mënyrë të detajuar të gjitha fushat e aktivitetit të ERRU-së në përmbushje të misionit të mësipërm, si edhe objektivat e punës së ERRU-së në të ardhmen në drejtim të forcimit të rolit të tij si institucion i pavarur. Në një kapitull të veçantë raporti analizon gjendjen dhe performancën e sektorit të ujit, reformën, si dhe jepen rekomandime për rritjen e performancës së tij në të ardhmen.

ERRU, Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë.

Baza kryesore ligjore e ushtrimit të aktivitetit të ERRU-së si institucion i pavarur është ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar. Ky ligj e ngarkon ERRU-në me përgjegjësitë e mëposhtme:

- vendosjen e tarifave të shërbimeve UK për shoqëritë UK;
- licencimin e shoqërive UK;
- mbrojtjen e interesave të konsumatorëve për garantimin e shërbimeve cilësore nga shoqëritë UK, si ndaj abuzimeve për shërbimet monopol të ujësjellës kanalizimeve të ujërave të ndotura.

Licencimi i Shoqërive UK

Gjatë vitit 2018 kanë aplikuar për licencë apo rinovim të saj në total 35 shoqëri UK, nga të cilat ERRU ka licencuar 25 shoqëri, ndërsa 10 aplikime të tjera janë në proces.

Në total janë të licencuara nga ERRU 42 shoqëri UK, janë në proces rinovimi 10 shoqëri dhe nuk janë licencuar 5 shoqëri, kryesisht shoqëri UK të vogla. Arsyet e moslicencimit të tyre mbas reformës administrative territoriale janë për shkak të vështirësive për emërimin e drejtuesve teknike të kualifikuar, mos regjistrimit të aksioneve në QKB, ndarjes së aseteve si dhe vështirësive në pajisjen me Akt Miratimin Higjenu Sanitar nga ISHSH.

ERRU në bashkëpunim me ISHSH dhe MIE ka marrë iniciativën për të vendosur ligjërisht në kushte më praktike procesin e marrjes së Akt Miratimin Higjenu Sanitar, si dhe rishikimin e akteve nënligjore që kushtëzojnë kërkesat për emërimin e drejtuesve teknikë, veçanërisht për shoqëritë e vogla.

Procesi i Miratimit të Tarifave për Shërbimet UK

Gjatë vitit 2018 ERRU ka miratuar tarifa për 8 shoqëri UK, përkatësisht Malësi e Madhe, Maliq, Gramsh, Skrapar, Vau Dejës, Librazhd – Prrenjas, Poliçani dhe Gjirokastër. Janë në proces vlerësimi 11 aplikime nga shoqëritë UK përkatësisht: Lushnje, Vlorë, Roskovec, Delvinë, Krujë, Berat-Kuçovë, Bulqiza, Pustec, Vorë, Tropojë dhe Himarë.

Aplikimet kanë qenë të nevojshme si pasojë e rritjes së zonës së shërbimit pas reformës territoriale dhe unifikimit të tarifave për të gjithë zonën, si edhe për rritjen e të ardhurave për të mbuluar kostot direkte dhe totale të shërbimeve UK.

Procesi i miratimit të tarifave nga ERRU shoqërohet me analiza të hollësishme që marrin në konsideratë vetëm kostot e arsyeshme dhe të justifikuar, të cilat duhet të jenë të lidhura ngushtë me rritjen e performancës së operatorëve dhe me rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve. Gjatë analizës dhe aprovimit të tarifave ERRU përdor gjithashtu kriterin e përbalueshmërisë së pagesës së faturës nga konsumatorët, kriteri i cili po rishikohet në përputhje dhe me eksperiencat ndërkombëtare në konsultim me Shoqatën e Rregullatorëve të Europës (WAREG).

**Trajtimi i
Ankesave të
Konsumatorëve**

ERRU, nëpërmjet trajtimit të ankesave të konsumatorëve, synon garantimin që shoqëritë UK të veprojnë në përputhje me rregulloren për furnizimin me ujë dhe kanalizimeve në zonën e shërbimit me kushtet e licencës së tyre, si dhe kushtet e përgjithshme të kontratës që ato kanë me konsumatorët. Gjatë vitit 2018 ERRU ka shqyrtuar dhe trajtuar 39 ankesa të ardhura kryesisht nga konsumatorë familjarë.

Natyra e ankesave të paraqitura pranë ERRU-së kanë qenë mbi faturimin aforfe, zëvendësimin e shpeshtë të ujëmatësit pa respektuar procedurat, mosnjohjen e detyrimeve nga ana e konsumatorëve, problemet me kontratën për shërbime ujësjellës kanalizime, etj. Pjesa dërmuese e ankesave ka konsistuar për faturimin aforfe dhe për ndërrimin e shpeshtë të ujëmatësit.

ERRU i ka trajtuar me seriozitetin maksimal dhe me objektivitet këto ankesa duke i zgjidhur 10 prej tyre në favor të konsumatorëve. Pjesa tjetër është zgjidhur me mirëkuptim ndërmjet palëve ose është akoma në proces.

**Përmirësimi i
Standarteve në
Sektorin e UK
Nëpërmjet
Instrumentave
Rregullatore**

Gjatë vitit 2018 ERRU, ka vijuar me punën për të përmirësuar instrumentet rregullatore që lidhen me aplikimin për ndryshimin e tarifave, përkatësisht:

- **“Metodologjia e Vendosijes së Tarifave”**, drafti i të cilës është përfunduar, por pritet të finalizohet brenda 6 muajve të parë të 2019 duke përfshirë dhe eksperiencat më të mira nga konsultimi me Shoqatën e Rregullatorëve të Europës WAREG.

Drafti i ri merr parasysh realitetin e sektorit ku shumica e shoqërive UK janë të paqëndrueshme financiarisht, si dhe rastin për shoqëritë UK që kanë një performancë financiare shumë të mirë, të cilat aplikojnë për ndryshimin e tarifave për të mbuluar shlyerjen e kredive dhe nevojat për investime.

Metodologjia e re përfshin detyrimin që do të kenë shoqëritë kur propozojnë për tarifa të reja për të paraqitur një plan biznesi 5 vjeçar, si dhe dorëzimin e një raporti vjetor performance pranë ERRU-së në zbatim të planit të biznesit dhe të tarifave të aprovuara nga ERRU.

Gjatë analizës së propozimeve për tarifa të reja, metodologjia parashikon gjithashtu rishikimin e gamës së treguesve kryesorë të performancës, si dhe të peshës së secilit në funksion të vendosjes së objektivave për shoqërinë UK.

- **“Rregullore për Organizimin e Seancës Dëgjimore me Publikun”** u miratua më datë 21.09.2018. Miratimi i saj erdhi si rrjedhojë e nevojës së përmirësimit dhe rritjes së efektivitetit të komunikimit me publikun me rregulla të qarta dhe të zbatueshme në organizimin e seancës dëgjimore.

Rregullorja e re është pasuruar më tej edhe me një model prezantimi i cili duhet të përmbajë në mënyrë të përmbledhur dhe lehtësisht të kuptueshme nga publiku informacionin që shoqëria duhet të prezantojë në justifikim të tarifave të reja të propozuara. Ky model duhet të aprovohet paraprakisht nga ERRU dhe më tej vazhdohet me zhvillimin e seancës dëgjimore.

Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së

Burimet e financimit të aktivitetit e veprimtarisë së ERRU janë pagesat rregullore vjetore dhe ato për licencime që duhet të paguajnë shoqëritë UK. Detyrimi i pagesave rregullore për 2018 ishte në shumën **48,446,450 lekë**.

Të ardhurat totale të realizuara gjatë vitit 2018 janë në shumën **80,870,363 lekë**, Detyrimi vjetor i planifikuar i arkëtimeve ka qenë **48,446,450 lekë**, pra rezulton që në vitin 2018 janë mbledhur **31,360,976 lekë** më shumë nga detyrimet e prapambetura që shoqëritë UK kanë pasur ndaj ERRU-së.

Shpenzimet buxhetore të kryera nga ERRU gjatë vitit 2018, janë në shumën **44,162,369 lekë, ose 89 % të fondit të planifikuar të shpenzimeve operative**.

Ulja e shpenzimeve krahasuar me ato të planifikuara ka ardhur kryesisht nga ulja e zërave shpenzime në energji elektrike, shpenzime për aktivitete dhe mirëmbajte mjete transporti.

Në mbyllje të vitit 2018, gjendja e mjeteve financiare të disponueshme në llogarinë bankare të ERRU garanton plotësisht projekt buxhetin e vitit 2019.

Performanca e Sektorit UK dhe Analiza e çdo Treguesi të Veçantë

ERRU monitoron performancën e secilës shoqëri UK dhe të sektorit UK në tërësi. Ky raport bazohet në të dhënat e 9 mujorit të vitit 2018, të vëna në dispozicion nga AKUM dhe të ekstrapoluara për kohëzgjatjen vjetore të tyre.

Analiza e plotë e sektorit në përgjithësi, dhe e çdo shoqërie UK në veçanti, do të jepet në Raportin Vjetor të Performancës që hartohet dhe botohet nga ERRU në fund të qershorit të vitit 2019, pasi të disponohen të dhëna të plota vjetore të shoqërive UK. Treguesit Kryesorë të Performancës së sektorit UK për vitin 2018 paraqiten si më poshtë:

Treguesit e Performancës	2017	2018	Tendenca
Mbulimi me Furnizimin me Ujë (%)	78.3	78.2	=
Mbulimi me Kanalizime (%)	50.2	51.6	↗
Mbulimi i Kostove O&M (%)	109	124	↗
Norma e Arkëtimit Korente (%)	78.84	79	=
Niveli i Matjes (%)	68.3	73.3	↗
Ujë Pa të Ardhura (%)	65	63.4	↗
Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje)	5.5	5.32	↗
Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	12	11.65	↘

Vlerat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2018 paraqesin një përmirësim të lehtë të situatës teknike ekonomike të sektorit që argumentohet me një angazhim në rritje të stafit drejtues të shoqërive UK në intensifikim të reformës në sektorin e ujësjellës kanalizimeve që ka ndërmarrë qeveria qendrore.

"Mbulimi me Furnizimin me Ujë" ka një përkeqësim të vogël me 0.09% krahasuar me vitin 2017. Popullsia në juridiksion ka pësuar një rritje me rreth 292.579 banorë dhe nga ana tjetër dhe popullsia e shërbyer është rritur me rreth 226.910 banorë. Përkeqësimi argumentohet me përfshirjen në zonën e shërbimit të shoqërive UK të riorganizuara të mjaft zonave rurale (zona të bardha) në të cilat nuk ekzistojnë sisteme inxhinierike të furnizimit me ujë.

"Mbulimi me Kanalizime" ka një përmirësim me 1.4% krahasuar me vitin 2017. Duke patur parasysh që popullsia është rritur në zonën e shërbimit të shoqërive të riorganizuara, ky tregues duhet të ishte përkeqësuar akoma më shumë sesa ai

i mbulimit me shërbime të furnizimit me ujë, sepse është evident fakti që përgjithësisht mungojnë rrjetet e kanalizimeve të ujërave të ndotura në zonat rurale. Pra, ky tregues nuk rezulton i besueshëm dhe kërkon verifikime të mëtejshme të të dhënave të tij.

"Mbulimi i Kostove O&M" është përmirësuar me 15% krahasuar me vitin paraardhës pasi të ardhurat nga aktiviteti UK janë rritur ndjeshëm me rreth 18%, ndërkohë që kostot O&M janë rritur vetëm me rreth 3%.

Kostot janë ulur kryesisht në zërat e energjisë elektrike dhe të riparimeve që tregon për përmirësim të aspekteve të menaxhimit nga stafi drejtues i shoqërive UK.

"Norma e Arkëtimit Korente" për të tretin vit radhazi mbetet në të njëjtin nivel rreth 79%, pavarësisht përfshirjes së zonave rurale nën administrimin e shoqërive UK të cilat në përgjithësi këtë tregues e kanë mjaft nën mesataren në nivel kombëtar. Përmenden shoqëri me performancë shumë të mirë, si Tiranë, Berat-Kuçovë, Korçë, Maliq, Peqin, Librazhd, por ka ende shoqëri me nivele të ulëta arkëtimit nën 60%, si Kukës, Peshkopi, Gramsh.

"Uji Pa të Ardhura" ka një përmirësim me 2%, por ende mbetet në nivele të larta. Për vitin 2018 mesatarisht prodhohet 304 litra ujë në ditë për frymë ndërkohë që faturohet 107 litra. Performanca pozitive e këtij treguesi duhet marrë me rezervë, sepse llogaritja e tij bëhet në baza vlerësimi (jo matje) për shkak të mungesës në përgjithësi të matësive të ujit në burim.

"Niveli i Matjes" është përmirësuar me 5% si rezultat i investimeve në sektor.

"Efiçenca e Stafit" ka një përmirësim minimal me 0.18%. Pavarësisht rritjes së konsiderueshme të numrit të lidhjeve të ujit, efekti pozitiv është minimizuar, sepse në total stafi i shoqërive UK është rritur me 333 punonjës. Rritja e efiçencës së stafit duhet parë si përparësi e shoqërive UK në të ardhmen.

"Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë" është përkeqësuar me 0.35 orë më pak furnizim me ujë të pijshëm në 24 orë, që justifikohet, sepse shumë shoqëri janë riorganizuar gjatë vitit 2018 duke marrë zona rurale të shërbyera me orare të reduktuara apo zona krejtësisht të pa shërbyera.

**Situata në
Zbatim të
Reformës në
Sektorin e UK**

Reforma në sektorin e ujit e cila i ka fillimet e saj në Janar 2016 me VKM nr. 63 që presupozonte riorganizimin e shoqërive UK sipas parimit 1 shoqëri = 1 bashki dhe që duhet të kishte përfunduar në fund të vitit 2016. Ky proces akoma nuk ka përfunduar, sepse deri në fund të vitit 2018 janë licencuar nga ERRU 30 shoqëri UK të riorganizuar, ndërkohë vetëm 15 prej tyre kanë aplikuar për miratimin e tarifave të reja për zonën e re të shërbimit.

Në vijim të reformës në sektorin e ujit të lançuar nga qeveria qendrore që në Tetor të vitit 2017, me synim shëndoshjen financiare të shoqërive UK, krahas fushatës për eliminimin e lidhjeve të paligjshme në Janar 2018 u procedua me nënshkrimin e kontratave të performancës ndërmjet MIE dhe Bashkive bazuar në tregues performance të përcaktuar apriori dhe në vlera të njëjta për të gjitha shoqëritë.

Për vitin 2018 si rezultat i reformës, sektori pati një ecuri pozitive në drejtim të eliminimit të lidhjeve të paligjshme, rritjes së numrit të ujëmatësive të vendosur, si dhe të arkëtimeve të debive të prapambetura.

Në fund të vitit 2018 vlerësohet një përmirësim i lehtë i gjendjes financiare të sektorit, por nuk u arritën pritshmëritë e parashikuara nga reforma, sidomos në drejtim të influencës së uljes së humbjeve nga eliminimi i lidhjeve të paligjshme.

Në fund të vitit 2019 për përshpejtimin dhe arritjen e përmirësimit të gjendjes në sektor MIE ka përpiluar një draft qasje që akoma është në diskutim me të gjithë aktorët në sektor para se të formalizohet për zbatim.

Qasja e propozuar për shëndoshjen e sektorit të UK presupozon në princip agregimin "e detyruar" në një shoqëri të vetme të shoqërive me performancë të dobët financiare që do të menaxhohet nga një staf qendror (Struktura e Kompetencave të Përbashkëta ose SKP). Kjo shoqëri e agreguar rrezikon që të jetë gjigande dhe me vështirësi menaxhimi sepse aktualisht rreth 40 shoqëri UK nuk arrijnë të mbulojnë 100% të kostove direkte.

**Objektivat e
ERRU-së për
Vitin 2019**

- ❖ Në zbatim të urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 581, datë 18.07.2018, ERRU do të kontribuojë në Grupin e Punës për hartimin e një ligji të ri për sektorin UK me propozime dhe komente, në veçanti për rishikimin ligjit nr. 8102.
- ❖ Përfundimin e punës për rishikimin dhe hartimin e "Metodologjisë së vendosjes së tarifave për shërbimin e UK" në përputhje me kërkesat për një menaxhim bashkëkohor të sektorit dhe përfshirjen e eksperiencave më të mira të rregullatorëve Europianë në të. Metodologjia e përmirësuar do të ketë si bazë vlerësimi performancën tekniko-ekonomike të shoqërive, objektivat për përmirësimin e tyre në përputhje me planin e biznesit 5-vjeçar të shoqërisë, si dhe plotësimin të nevojave për investime.
- ❖ Të luajë një rol nxitës dhe ndërgjegjësues që në vazhdimësi të reformës të fillojë realizimi i 2-3 shembujve pilot agregimi të suksesshëm të shumë shoqërive UK në sektor. Një sektor mjaft i fragmentarizuar si i yni, me rreth 60 shoqëri UK, vuan nga mungesa e ekonomisë së shkallës dhe operon me kosto mjaft të larta. Së shpejti, pritet që vendi ynë të hapë negociatat për pranimin në Bashkimin Europian, ku pritet alokimi i fondeve të konsiderueshme nga BE për sektorin UK në përmbushje të standardeve të direktivës së ujit të KE, përthithja e të cilëve lehtësohet mjaft nga një sektor UK i agreguar. Agregimi duhet të mbështetet me incentiva (financime) nga qeveria qendrore.
- ❖ Miratimi i rregullores së trajtimit të ankesave të konsumatorëve brenda vitit 2019. ERRU ka rolin e ndërmjetësuesit dhe rekomanduesit në trajtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis ankesave të konsumatorëve dhe shoqërive UK. Prandaj kjo rregullore shihet si një instrument i nevojshëm në mbështetje të procedurave sipas akteve në fuqi për një zgjidhje sa më të drejtë dhe efikase të ankesave të konsumatorëve.
- ❖ ERRU të planifikojë rishikimin dhe miratimin e Kodit të Ujit, si akt nënligjor që duhet të jetë në kompetencë të saj (jo të Këshillit të Ministrave).
- ❖ Të rrisë kapacitetet profesionale të stafit me një planifikim të drejtë të trajnimit të tyre me burime të brendshme dhe të jashtme duke shfrytëzuar edhe mundësitë nga bashkëpunimet e gjëra dhe bilaterale me rregullatorët Europianë të sektorit të ujit.
- ❖ Të rrisë përpjekjet për të patur një bazë të dhënash të sakta duke rritur kërkesat ndaj shoqërive UK, që është pjesë e propozimit të kalimit të Njesisë së Monitorimit të Benchmark-ut nga AKUM tek ERRU.
- ❖ Të marrë pjesë aktive në të gjithë Grupet e Punës dhe të aktiviteteve me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar ku trajtohen dhe diskutohen çështje thelbësore strategjike dhe tematika të veçanta të sektorit UK dhe në veçanti të kuadrit rregullator.

**Rekomandime
për
Përmirësimin e
Performancës së
Sektorit UK dhe
të ERRU-së**

Për vazhdimësinë e një reforme të suksesshme në sektorin UK, dhe të përmirësimit të performancës së ERRU-së rekomandohet:

- Në vend të qasjes së propozuar të vazhdohet procesi i vlerësimit të treguesve të performancës (të arritjes së objektivave) për secilën shoqëri UK, si proces mjaft i rëndësishëm në përcaktimin e instrumentave përkatës për shëndoshjen financiare.
- Në kontratat e reja të performancës përveç AKUM të përfshihet edhe ERRU në procesin e vlerësimit të treguesve të performancës, dhe në përcaktimin e objektivave për shoqëritë në të ardhmen.
- Paralelisht me procesin e mësipërm duhet të punohet për nisjen e procesit të agregimit si avantazh i ekonomisë së shkallës sipas principit “në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore” duke synuar fillimisht që të realizohen 2-3 agregime të suksesshme. Për këtë duhet të mundësohet një anketë në të gjitha bashkitë e vendit ku të përcaktohen vendet e mundshme të suksesshme për agregim. ERRU duhet të paravlerësojë tarifat e agreguara në rastet e seleksionuara për agregim.
- Të vazhdojë puna për hartimin e akteve të nevojshme nënligjore për saktësimin e procedurave të lëshimit të Akt Miratimit Higjeno Sanitar për shoqëritë UK, si dhe të Inspektimeve Higjeno Sanitare në elementët e sistemeve të furnizimit me ujë.
- Në vend të hartimit të një ligji të ri për sektorin UK të rishikohet vetëm ligji aktual nr. 8102 për kuadrin rregullator, si akt që rregullon të gjithë sektorin UK që duhet të konsistojë përgjithësisht në forcimin e rolit të ERRU si institucion i pavarur. Rishikimi duhet të përfshijë:
 - Saktësimin e kompetencave të ERRU-së si institucioni që monitoron operatorët dhe në përgjithësi sektorin UK, si dhe shmangien e mbivendosjes së kompetencave me AKUM.
 - Përfshirjen në strukturën e ERRU-së të njësisë së benchmark-ut që aktualisht ndodhet në AKUM.
 - Anëtarët e Komisionit të ERRU-së, përfshirë dhe Kryetarin të emërohen nga Kuvendi i Shqipërisë.
 - Kufizimin e karakterit mjaft të përgjithshëm të kërkesave ndaj profilit të anëtarëve të komisionit duke i saktësuar ato në përputhje me kompetencat dhe fushën e aktivitetit të institucionit të ERRU-së në sektorin e ujit.
 - Mandati i anëtarëve të komisionit të jetë 5 vjeçar në vend të atij aktual 4 vjeçar.
 - Përmirësimin e disa elementëve jo thelbësorë të pavarësisë aktuale financiare të institucionit.
 - Përmirësimin e disa aspekteve që lidhen me përmbushjen nga operatorët të disa kërkesave shtesë gjatë procesit të licencimit dhe sidomos në atë të tarifave.
 - Përmirësimin në drejtim të efektivitetit dhe zbatimit real në praktikë të neneve që lidhen me kundërvajtjet e operatorëve për shkeljet e ndryshme ku penalitetet propozohen të jenë në ngarkim të personit përgjegjës dhe jo të institucionit.

1 Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator të Ujit

1.1 Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) është institucion i pavarur publik, i cili e bazon veprimtarinë e tij në aktet ligjore dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre si më poshtë:

- Ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102);
- Ligji nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” (ligji nr. 120/2016);
- Ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar (ligji nr. 9902);
- Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121);
- Ligj nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë (Kodi i Procedurës Administrative);
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (Kodi i Punës);
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar (ligji nr. 10296);
- Ligji nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” (ligji nr. 9584);
- Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” (ligji nr. 8480).

ERRU është ngritur dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar. Qëllimi kryesor i ligjit nr. 8102 është mbrojtja e interesave publike dhe krijimi i një mjedisi transparent dhe ligjor në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

Në zbatim të urdhrat të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 581, datë 18.07.2018, ERRU ka marrë pjesë në grupin ndërinstucional të punës të ngritur për hartimin e ligjit të ri për sektorin ujësjellës kanalizime, pjesë kryesore dhe integrale e të cilit do të jetë ligji nr. 8102. ERRU ka marrë pjesë aktivisht në sesionet përkatëse të diskutimit të draft-projektit të këtij ligji me propozime dhe komente përkatëse. Propozimet për rishikimin e ligjit aktual nr. 8102 kanë konsistuar përgjithësisht në forcimin e rolit të ERRU si institucion i pavarur.

Në veçanti propozohet që:

- të saktësohen kompetencat e ERRU-se si institucioni që monitoron operatorët dhe në përgjithësi sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura, shmangien e mbivendosjes së kompetencave me AKUM, si dhe përfshirjen në strukturën e saj të njësisë së benchmarkut që aktualisht ndodhet në AKUM;
- anëtarët e komisionit të ERRU-së, përfshirë dhe kryetarin të emërohen nga Kuvendi i Shqipërisë;

- të zbutet karakteri mjaft i përgjithshëm i kërkesave ndaj profilit të anëtarëve të komisionit duke e saktësuar atë në përputhje me kompetencat dhe fushën e aktivitetit të institucionit të ERRU-së në sektorin e ujit;
- mandati i anëtarëve të komisionit të jetë 5 vjeçar në vend të atij aktual 4 vjeçar;
- të përmirësohen disa elementë jo thelbësorë të pavarësisë aktuale financiare të institucionit;
- të përmirësohen disa aspekte që lidhen me përmbushjen nga operatorët të disa kërkesave shtesë gjatë procesit të licencimit dhe sidomos në atë të tarifave;
- përmirësimi në drejtim të efektivitetit dhe zbatimit real në praktikë i neneve që lidhen me kundërvajtjet e operatorëve për shkeljet e ndryshme ndaj detyrimeve të diktuar në licencën e lëshuar nga ERRU, si dhe të tarifave të aprovuara prej saj.

Lidhur me legjislacionin ku ERRU duhet të ushtrojë përgjegjësitë e veta ligjore përmendim:

Ligji nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” ka për qëllim të lehtësojë e nxisë ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, duke promovuar përdorimin e përbashkët të infrastrukturës fizike ekzistuese dhe një zhvillim më efikas të infrastrukturës fizike të re, nëpërmjet ndërtimit të rrjeteve të shpejtësisë së lartë me kosto më të ulët, reduktimit të procedurave, si dhe sigurimit të së drejtës së kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë.

Në rastet kur do të lindin mosmarrëveshje mbi refuzimin e aksesit apo termat dhe kushtet specifike, duke përfshirë edhe çmimin, ERRU do të jetë autoriteti përgjegjës për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve, kur aksesit është kërkuar nga një sipërmarrës i komunikimit elektronik të një operator rrjeti që vepron në sektorin e furnizimit me ujë, të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura.

Gjithashtu ligji nr. 71/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar” parashikon ngritjen pranë ERRU të një strukture për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve mes konsumatorëve dhe operatorëve për veprimtaritë në fushën e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

1.2 Detyrime ndaj Rekomandimeve të “Progresraportit të BE-së për Shqipërinë

ERRU nuk është subjekt i detyrimeve ndërkombëtare, si dhe i rekomandimeve të “Progresraportit për Shqipërinë” që duhen plotësuar prej saj.

1.3 Struktura Organizative e ERRU-së

Struktura dhe organika e ERRU-së rregullohen në përputhje me ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”. Si institucion i pavarur, i krijuar me ligj, struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të nëpunësve të Entit, miratohen me vendim të Kuvendit.

Struktura dhe organika e ERRU-së janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 34/2016, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)". Në përbërje të Entit Rregullator të Ujit është Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), Drejtoria Tekniko-Ekonomike, Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse. Struktura organizative e ERRU-së, jepet në figurën 1.




Figura 1. Struktura e Entit Rregullator të Ujit

Në përbërje të strukturës së ERRU-së janë gjithsej 28 punonjës, 5 anëtarë komisioni, 20 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës.

Kjo strukturë, ka për qëllim rritjen e efikasitetit, profesionalizmit dhe të pavarësisë operacionale të rregullatorit duke forcuar bashkërendimin dhe koordinimin e punëve midis strukturave, përshtatjen e tyre me detyrat dhe sfidat që ERRU-ja ka përballë reformës territoriale të sektorit ujësjellës kanalizime që burojnë nga objektivat strategjike të institucionit.

ERRU, në vazhdimësi, do të propozojë ndryshime të strukturës organizative në funksion të përmirësimit të performancës së saj, si aktor kryesor në sektorin e ujit, dhe në përgjigje të kërkesave të reja që parashtron vazhdimësia e reformës në sektorin e ujit dhe rritja e performancës së saj në përgjithësi.

1.4 Veprimtaria Rregullatore dhe Monitoruese

1.4.1 Licencimi i Operatorëve UK

Enti Rregullator i Ujit ka vazhduar të kryejë funksionet e tij, duke zbatuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të gjitha shoqëritë UK në lidhje me licencimin e tyre në zbatim të kërkesave ndaj reformës administrative-territoriale.

Gjatë vitit 2018, në sektorin ujësjellës kanalizime kanë ushtruar veprimtarinë e tyre 57 shoqëri për kategorinë e shërbimit të "grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik". Nga këto shoqëri

vetëm 2 prej tyre disponojnë në licencë edhe kategorinë e "përpunimit të ujit të pijshëm për konsum publik", 48 prej tyre edhe atë të "grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura", dhe vetëm 4 shoqëri UK disponojnë në licencë edhe kategorinë e "përpunimit të ujërave të ndotura".

Në vendin tonë aktualisht janë në funksion tetë (8) impiante të përpunimit të ujërave të ndotura, katër (4) prej të cilave nuk janë të licencuara nga ERRU. Këto të fundit akoma nuk kanë arritur ende të plotësojnë kërkesat për plotësimin e dokumentacionit përkatës që duhet të paraqesin pranë ERRU-së për marrjen e licencës për këtë kategori shërbimi.

Gjatë vitit 2018 kanë aplikuar për licencë apo rinovim të saj tridhjetë e pesë (35) shoqëri UK në total. Arsyet kryesore të kërkesës për licencim kanë qenë:

- a) përfundimi i afatit të licencës: kanë aplikuar 17 (shtatëmbëdhjetë) shoqëri;
- b) ndryshimi i zonës së shërbimit pas reformës administrative-territoriale: kanë aplikuar 5 (pesë) shoqëri;
- c) shtim të kategorisë C, për largimin e ujërave të ndotura: kanë aplikuar 6 (gjashtë) shoqëri;
- d) ndryshimet në drejtuesit ligjor dhe/ose teknik: kanë aplikuar 6 (gjashtë) shoqëri;
- e) krijimi i shoqërive të reja: kanë aplikuar 4 (katër) shoqëri përkatësisht: Sh.a UK Finiq dhe Sh.a UK Dropull, Sh.a UK Konispol dhe sh.a UK Pustec.

Theksohet fakti se procesi i licencimit të shoqërive UK që përfshihen në pikën b) dhe c) gjatë vitit 2018 ka qenë i lidhur ngushtë edhe me zbatimin e VKM nr. 63, datë 27.01.2016, ku parashikohet se të gjitha shoqëritë duhet të përfundojnë inventarizimin e asetëve të të gjitha sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të njësive administrative (ish-komunat) që kanë marrë në juridiksionin e tyre, proces i cili akoma nuk ka përfunduar në të gjithë shoqëritë.

ERRU vazhdimisht ka nxitur shoqëritë që të vazhdojnë me procesin e inventarizimit në zbatim të riorganizimit të sektorit UK, reflektimit të këtyre ndryshimeve në QKB dhe më pas paraqitja në ERRU për licencim dhe miratimin e tarifave në përmbushje dhe të kërkesave të VKM nr. 63, datë 27.01.2016. Kjo gjë është theksuar në mënyrë të veçantë në të gjitha takimet që ERRU ka realizuar me Kryetarët e Bashkive dhe drejtuesit ekzekutivë të shoqërive UK gjatë vitit 2018.

Si përfundim, gjatë vitit 2018 KKRR ka licencuar njëzet e pesë (25) shoqëri, ndërsa dhjetë (10) aplikime të tjera mbeten në proces (shih aneksi 1, tabela 1).

Aplikimet në proces janë për arsye se ende këto shoqëri nuk kanë plotësuar kërkesat në zbatim të VKM nr. 958 për liçensimin e operatorëve nga ERRU në fushën e ujësjellës kanalizimeve, përkatësisht për :

- **Marrjen e akt-miratimit higjeno-sanitar**, nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor. Kjo ka ardhur kryesisht sepse shoqëritë kanë zgjeruar zonën e shërbimit me zona shtesë rurale që kanë asete mjaft të amortizuara të sistemeve të furnizimit me ujë, si dhe shoqëritë e reja të krijuara rishtas në sektor, përkatësisht Pustec, Kamëz dhe Klos;
- **Emërimin e drejtuesve teknikë**, të kualifikuar sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 958;

Vështirësitë që shoqëritë po hasin për përmbushjen e këtyre kushteve vazhdojnë të jenë pengesat kryesore për licencimin dhe rinovimin e licencës në kohë të shoqërive UK.

Situata e licencimit deri në fund të vitit 2018 për 57 shoqëritë UK (shih Figurën 2) është si më poshtë:

- Dyzet e dy (42) operatorë disponojnë licenca të vlefshme;
- Dhjetë (10) operatorë janë në proces të rinovimit të licencës;
- Tre (3) operatorë janë me licencë të pavlefshme dhe që nuk kanë aplikuar për rinovim licence, përkatësisht Sh.a UK Pukë, Sh.a U Divjakë, Sh.a UK Peqin, të cilat kanë probleme me regjistrimin dhe përditësimin në QKB, ndërsa Sh.a UK Peqin për shkak të problemeve me cilësinë e ujit dhe nuk arrin të pajiset me akt-miratimin higjieno-sanitar.
- Dy (2) operatore janë të rinj dhe nuk janë pajisur asnjëherë me licencë, UK Kamëz dhe UK Klos pasi nuk kanë plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për licencim.




Figura 2. Situata aktuale e licencimit

Në figurën 2, jepet situata e licencimit në përqindje, ndërsa për secilën nga 57 shoqëritë UK jepet në aneksin 1, tabela 2.

1.4.2 Tarifat dhe Procesi Tarifor

Në zbatim të ligjit nr. 8102, ERRU është autoriteti që miraton tarifën e shërbimeve UK si dhe përcakton metodologjinë e përllogaritjes së tarifave.

Procedura për vendosjen e tarifave fillon me propozimin e bërë nga i licencuari, dhënien e mendimit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, marrja e informacionit mbi opinionet dhe reagimet e konsumatorëve gjatë seancës dëgjimore me publikun që zhvillon shoqëria, dhe përfundon me miratimin përfundimtar të tarifave nga Enti Rregullator i Ujit.

Gjithashtu në zbatim të rekomandimeve që Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar me rezolutën për vitin 2018, ERRU është angazhuar maksimalisht për përballimin në kohë dhe me cilësi të gjithë aplikimeve për propozim të ndryshimit të tarifave.

ERRU është treguar e kujdesshme në politikën e miratimit të tarifave në realizimin e analizave të hollësishme duke marrë në konsideratë vetëm kostot e arsyeshme dhe të justifikuar dhe të lidhura ngushtë me rritjen e performancës së operatorëve, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorit. Monitorimi i tarifave të miratuara është pjesë e vijimit të punës nga ERRU.

Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), bazuar në kompetencat që i jep ligji, ka miratuar rregullat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha subjektet e licencuara, si më poshtë:

- Vendimi nr. 39, datë 09.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" ;
- Vendimi nr. 40, datë 09.12.2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura";
- Vendimi nr. 41, datë 09.12.2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura";
- Vendimi nr. 42, datë 09.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura";

Objektivi kryesor i ERRU-së në procesin e miratimit të tarifave është gjetja e balancës ndërmjet mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit.

Nevoja e ndryshimit të tarifave për shoqëritë UK argumentohet nga:

- Parashikimet e pikës 3 të kreut II të VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" ku parashikohet detyrimi i shoqërive UK për rishikimin e nivelit tarifor pas riorganizimit.
- Nevoja për unifikimin e tarifave për të gjithë zonën e shërbimit konstatohet në një pjesë të konsiderueshme të aplikimeve për ndryshim të tarifave. Ka patur dhe aplikime ku shoqëritë propozojnë tarifa të diferencuara midis zonës ekzistuese dhe asaj të shtuar, kjo për faktin se tarifat duhet t'i përgjigjen shërbimit të ofruar.
- Përmirësimi i situatës financiare të shoqërive pasi riorganizimi ka sjellë edhe një përkeqësim të financave të shoqërive.

Shoqëritë e riorganizuarat e kanë detyrim ligjor që të aplikojnë pranë ERRU-së, për miratimin e tarifave të reja, për unifikim të tyre, por dhe për tarifa të diferencuara për zonën ekzistuese si dhe për zonat e reja që ato kanë marrë në ngarkim kryesisht zonat rurale. Justifikimi bazë për tarifën e diferencuar është kryesisht diferenca në nivelin e shërbimeve të zonave të reja rurale që në zbatim të reformës i janë shtuar zonës së shërbimit të shoqërive.

Theksohet fakti se mungesa e historikut për shoqëritë e reja të ndryshuara sipas reformës ka rritur angazhimin dhe vëmendjen e stafit dhe të KKRR të ERRU-së për të realizuar me sa më shumë objektivitet analizën dhe vendimmarrjen për tarifën e reja.

Gjatë vitit 2018 kanë përfunduar procedurën dhe janë marrë vendimet për miratimin e tarifave të reja për shoqëritë në Tabelën 1.

Tabela 1. Tarifatat e miratuara nga KKRR për Vitin 2018

Nr.	Operatori	Viti i Aplikimit	Numri i Vendimit të ERRU-së	Data
1	UK Malësi e Madhe	2017	10	16.02.2018
2	UK Maliq	2017	11	16.02.2018
3	UK Gramsh	2017	33	11.05.2018
4	UK Skrapar	2017	34	11.05.2018
5	UK Vau Dejës	2018	74	19.10.2018
6	UK Librazhd - Prrenjas	2018	75	19.10.2018
7	UK Poliçani	2018	Projekt Vendim	17.12.2018
8	UK Gjirokastrë	2018	Projekt Vendim	07.12.2018

Tabela e mëposhtme paraqet një situatë të përmblodhur të aplikimeve për ndryshimin e tarifave.

Tabela 2. Shoqëritë në Proces për Ndryshimin e Tarifave

Nr.	Operatori	Faza e Aplikimit	Shënime
1	UK Himara	Vendimi nr.76 datë 06.11.2018 për fillimin e procedurës	Në proces të Analizës Teknike Ekonomike
2	UK Lushnje	Vendimi nr.63 datë 06.09.2018 për fillimin e procedurës	Në proces të Analizës Teknike Ekonomike
3	UK Vlorë	Vendimi nr.73 datë 01.10.2018 për fillimin e procedurës	Në proces të Analizës Teknike Ekonomike
4	UK Roskovec	Vendimi nr. 79 datë 26.11.2018 për fillimin e procedurës	Në proces të Analizës Teknike Ekonomike
5	UK Delvinë	Vendimi nr. 60 datë 06.09.2018 për fillimin e procedurës	Në proces të Analizës Teknike Ekonomike
6	UK Krujë	Vendimi nr. 72 datë 01.10.2018 për fillimin e procedurës	Në proces të Analizës Teknike Ekonomike
7	UK Berat-Kuçovë	Shtyrje afati sipas konkluzioneve të mbledhjes së KKRR datë 19.10.2018	Analiza teknike-ekonomike shtyhet në vitin 2019 për saktësim të të dhënave
8	UK Bulqizë	Aplikimi nr.19 prot. datë 24.01.2018	Mungon dokumenti "Leje Higjeno Sanitare" për licensim. Në pritje të njoftimit për zhvillimin e Seancës Dëgjimore me publikun.
9	UK Pustec	Aplikimi nr.14 prot, datë 08.02.2018	Në pritje të Lejes Higjeno Sanitare për licensim
10	UK Vorë	Aplikimi nr.577 prot, datë 26.06.2018	Mungon procesverbali i zhvillimit të seancës dëgjimore
11	UK Tropojë	Aplikimi nr. 119 prot, datë 19.12.2018	Është në fazën e plotësimit të dokumentacionit

Komisioni Kombëtar Rregullator, gjatë vitit 2018, ka marrë vendime për mos shqyrtim të aplikimeve për ndryshimin e tarifave dhe riaplikim, pasi shoqëritë nuk kanë arritur të plotësojnë dokumentacionin sipas afateve kohore të përcaktuara nga ERRU, përkatësisht për shoqëritë UK Shkodër, UK Krujë dhe UK Fier.

Parimisht të gjitha shoqëritë duhet të arrijnë të mbulojnë kostot e shërbimeve që ofrojnë me të ardhurat nga aktiviteti i tyre, ku faktori bazë për realizimin e tyre janë tarifat e shërbimeve. Ndryshimi i tarifave ka pasur përgjithësisht tendencë rritëse, në varësi të kushteve dhe zhvillimeve të ofrimit të shërbimit të çdo operatori.

Konstatohet se shumë shoqëri janë në vështirësi objektive financiare, nevoja për subvencione nga qeveria është e domosdoshme për një periudhë më afat gjatë. Subvencionet duhen adresuar drejt shoqërive që janë financiarisht të dobëta dhe nuk kanë ende mundësi të përballojnë kostot e domosdoshme për kryerjen e shërbimeve UK.

Gjatë analizës të aplikimeve dhe aprovimit të tarifave të reja nga shoqëritë UK, ERRU ka parasysh një kompleks faktorësh, si: shpenzimet, normën e arkëtimit, tendencën e performancës së shoqërisë, përballueshmërinë e pagesës së faturës nga konsumatorët, përbërjen e zonës së shërbimit (rurale, urbane), si dhe veçori të sistemeve të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve të ujërave të ndotura, mosha e aseteve, gjendja e tyre që influencon mjaft në nevojat për investime urgjente dhe afatmesme, shlyerja e detyrimeve ndaj kredi dhënësve për investimet e kryera, etj.

Në mjaft raste, shoqëritë vazhdojnë të paraqesin aplikimet për ndryshimin e tarifave me mangësi në dokumentacion dhe me pasaktësi në të dhënat. Kjo bën që dhe analizat si dhe vendimmarrjet për këto shoqëri të zgjaten në afatet kohore, derisa të plotësohet dokumentacioni në përputhje me standardet e përcaktuara në metodologjinë e vendosjes së tarifave.

Problem mbetet saktësia e të dhënave, e cila luan një rol parësor në përcaktimin e tarifave. Vërehet se ka shumë mospërputhje midis informacioneve që shoqëritë japin në AKUM me ato të paraqitura në aplikimin për ndryshimin e tarifave. Rritja e besueshmërisë së të dhënave vazhdon të mbetet një shqetësim dhe nga ana tjetër prioritet i punës së ERRU-së.

Pavarësisht angazhimit maksimal të ERRU-se për rakordimin e shifrave për një analizë dhe llogaritje të saktë të nevojave të shoqërisë për të ardhura, si dhe përcaktimin e objektivave për Treguesit Kryesorë të Performancës, problemi i verifikimit të saktësisë së të dhënave duhet të zgjidhet përfundimisht nga ana ligjore si kompetencë e saj duke transferuar njësinë e benchmark-ut nga AKUM në ERRU.

Problem tjetër mbetet mungesa e të dhënave për zonat shtesë, dhe sidomos të dhënat për asetet. ERRU ka këmbëngulur mjaft për marrjen e të dhënave për asetet shtesë të shoqërisë (edhe ato ekzistuese) duke stimuluar dhe rekomanduar edhe metoda ad-hoc, si të anketave për informacione nga njerëzit që kanë punuar edhe më parë në operimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Në përgjithësi, ERRU ka shpenzuar mjaft energji për marrjen maksimalisht të informacionit nga shoqëritë në mënyrë që analiza e saj të mbështetet në logjikën sikur shoqëria ka një Plan Biznesi,

dokumentacion i cili pritet të bëhet kusht i detyrueshëm ligjërish në aplikimet e ardhshme nga shoqëritë për tarifata e reja.

Kriter tjetër mjaft i rëndësishëm që ERRU merr parasysh gjatë analizës dhe aprovimit të tarifave të reja të propozuara nga shoqëritë është ai i ***Përballueshmërisë së Pagesës së Faturës së Shërbimeve nga Konsumatorët Familjarë, përmbushja e të cilit theksohet edhe në pikën nr.6 të Rezolutës së Parlamentit.***

Në funksion të këtij qëllimi, ERRU është duke përdorur disa instrumente rregullatore, si: struktura tarifore, subvencioni i kryqëzuar ndërmjet kategorive të ndryshme të konsumatorëve, opinionet nga seancat dëgjimore me publikun, si dhe të faktit që për mjaft shoqëri akoma është e nevojshme që të subvencionohen për të mbuluar kostot operative direkte.

ERRU përdor si kriter për përballueshmërinë e pagesës së faturës së shërbimeve UK, në nivelin prej 5% të të ardhurave (shpenzimeve) mesatare mujore të një njësie ekonomike familjare, informacion që e përlogarit dhe e publikon INSTAT në *“Anketën e Buxhetit të familjes viti 2017”*, për të gjithë qarqet e Republikës së Shqipërisë. Këto vlera tregojnë se ka ende hapësirë në drejtim të aftësisë paguese për të përballuar rritjen e tarifave.

Trajtimi i problemit të përballueshmërisë bazuar në informacionin e mësipërm është mënyra më objektive e vlerësimit të tij, mënyrë e cila jep një tablo më të qartë edhe të reagimit të pritshëm nga publiku kur propozohet rritja e tarifave, si dhe të ndërtimit të politikave sociale nga qeveria qendrore dhe ajo lokale.

ERRU është i gatshëm të bashkëpunojë me të gjithë aktorët e tjerë për të qartësuar më tej mënyrën e trajtimit dhe të kapërcimit të çështjes së përballueshmërisë.

ERRU ka në vëmendjen e saj në të ardhmen përmirësimin dhe saktësimin e kriterëve dhe metodologjisë së marrjes në konsideratë të faktorit të përballueshmërisë për aprovimin e tarifave edhe në konsultim me Shoqatën e Rregullatorëve të Europës (WAREG).

Nga ana tjetër, ERRU është duke lidhur ura bashkëpunimi me INSTAT në mënyrë që të mund të arrihet që nga anketat për shpenzimet familjare të shtresave të popullsisë, të mund të merren të dhëna të detajuara të tyre vetëm për shpenzimet e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve. Këto referenca do ta bëjnë akoma më objektive vendimmarrjen e KKRR për tarifata e propozuara nga shoqëritë UK në drejtim të mbrojtjes së konsumatorëve me të ardhura të ulëta dhe në raport me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK.

1.4.3 Statusi i Ankimeve Gjyqësore

Gjatë vitit 2018 Enti Rregullator i Ujit ishte pjesë e 5 proceseve gjyqësore, 4 prej të cilave të iniciuara nga vetë ERRU me objekt shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të pagesës rregullatore nga ana e shoqërive ujësjellës kanalizime. Pas përpjekjeve të vazhdueshme të Entit për nxitjen e shoqërive për shlyerjen e pagesave rregullatore, detyrimet e akumuluar në vite detyruan ERRU ti drejtohej gjykatës për zgjidhjen e problematikës së krijuar.

Aktualisht çështjet gjyqësore janë në fazat si më poshtë:

1. Res Publica, Pilo Prence – Enti Rregullator i Ujit, Bashkia Tiranë dhe Këshilli Bashkiak Tiranë

Palë paditëse: Res Publica dhe z. Pilo Prence

Palë e paditur: Enti Rregullator i Ujit, Bashkia Tiranë dhe Këshilli Bashkiak Tiranë

Objekti: Shfuqizimi i Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 79, datë 26.07.2017 "Për dhënie mendimi për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm" dhe shfuqizimi i Vendimit nr. 47, datë 07.11.2017, "Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a." të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.

Kjo çështje u shqyrtua nga Gjykata Administrative e Apelit dhe pas disa seancave gjyqësore, në datën 24.12.2018 trupë gjykues shpalli vendimin duke rrëzuar kërkesë padinë si të pabazuar në ligj dhe prova dhe lënien në fuqi të vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 79, datë 26.07.2017 "Për dhënie mendimi për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm" dhe Vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 47, datë 07.11.2017, "Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.".

2. Enti Rregullator i Ujit -Ujësjetllës Kanalizime Kukës sh.a.

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit

Palë e paditur: Ujësjetllës Kanalizime Kukës sh.a.

Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Kukës" sh.a. të paguajë shumën 295 000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u vendos që shoqëria UK Kukës sh.a t'i paguajë ERRU shumën 295 000 lekë.

3. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhine sh.a.

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit

Palë e paditur: Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhinë sh.a.

Objekti: Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Rrogozhinë sh.a" të shlyejë shumën 778 200 lekë si një detyrim i prapambetur kontraktual.

Kjo çështje është në shqyrtim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ku jemi në pritje të vendimit përfundimtar.

4. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh.a.

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit

Palë e paditur: Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh.a.

Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Krujë" sh.a. të paguajë shumën 1 586 200 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

Kjo çështje është në shqyrtim nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjetllës Kanalizime Peqin sh.a.

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit

Palë e paditur: Ujësjetllës Kanalizime Peqin sh.a.

Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Peqin" sh.a. të paguajë shumën 960 000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

Kjo çështje është në shqyrtim nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

1.4.4 Inspektimet

Gjatë vitit 2018, Enti Rregullator i Ujit ka zhvilluar disa inspektime pranë shoqërive ujësjetllës kanalizime bazuar në procedurën e miratuar sipas Rregullores së Inspektimit dhe Monitorimit të Veprimtarisë së Ofruesve të Shërbimit në Sektorin Ujësjetllës Kanalizime. Qëllimi i inspektimeve ka qenë zbatimi i ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar dhe kuadri nënligjor rregullator i nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

Si rezultat i inspektimeve të zhvilluara në tre shoqëri ujësjetllës kanalizime u konstatua dhe u morën masat si më poshtë:

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Kavajë sh.a. ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë dhe nuk shlyente brenda afatit detyrimet e pagesës rregullatore ndaj ERRU. Për këto arsye ndaj UK Kavajë u mor masa administrative gjobë në shumën 300 000 lekë për ushtrimin e veprimtarisë pa licencë si dhe gjobë në shumën 100 000 lekë për mospagimin e detyrimeve financiare ndaj Entit Rregullator, brenda afateve kohore të përcaktuara nga ky institucion.

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Tropojë sh.a. nuk zbatonte vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 13.10.2004 "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik të sh.a ujësjellës Tropojë". Për këtë arsye ndaj UK Tropojë u mor masë administrative gjobë në shumën 100 000 lekë për moszbatim të vendimeve të Entit Rregullator të Ujit për tarifën.

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a. nuk shlyente detyrimet e pagesës rregullator ndaj Entit Rregullator të Ujit dhe nuk zbatonte vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 14, datë 09.06.2014 "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Peshkopi". Për këto arsye ndaj UK Dibër sh.a. u mor masë administrative gjobë në shumën 100 000 lekë për mos zbatim të vendimit të Entit Rregullator të Ujit për tarifën, si dhe gjobë në shumën 100 000 lekë për mospagimin e detyrimeve financiare ndaj Entit Rregullator, brenda afateve kohore të përcaktuara nga ERRU.

Asnjë nga shoqëritë e mësipërme nuk e ka ankimuar masën administrative, ndërkohë që ERRU ka vijuar me procedurat për vënien në ekzekutim të gjobave të vendosura.

Inspektimet patën efekt pozitiv edhe në kuadër të përmbushjes nga shoqëritë UK të detyrave të lëna nga grupet e inspektimit, ku vlen të theksohet se shoqëria UK Tropojë ka aplikuar për nivel të ri tarifor, ndërsa UK Kavajë ka aplikuar për rinovim të licencës dhe tashmë është një shoqëri e licencuar nga ERRU për tre kategori shërbimesh, përkatësisht : I. grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik, II. për përpunimin e ujit për konsum publik, dhe III. për largimin e ujërave të ndotura. Problematike mbetet situata e kësaj shoqërie për licencimin e saj për kategorinë e trajtimit të ujërave të ndotura.

ERRU nuk e ka konsideruar marrjen e masave administrative si qëllim në vetvete të punës së tij por duke patur si qëllim kryesor rritjen e cilësisë së shërbimit të operatorëve dhe zbatimin rigoroz të dispozitave ligjore. Për këtë arsye është përpjekur në mënyrë konstante për të rregulluar sektorin pa arritur deri në marrjen e masave, duke njoftuar në mënyrë të vazhdueshme shoqëritë si dhe duke zhvilluar takime paraprake me drejtuesit e tyre dhe Kryetarët e Bashkive përkatëse për zgjidhjen e problematikave dhe zbatimin e detyrimeve ligjore që shoqëritë duhet të respektojnë.

Inspektimet dhe marrja e masave administrative ndaj shoqërive ujësjellës kanalizime, të cilat nuk përmbushin në kohë apo nuk zbatojnë detyrimet ligjore që kanë ndaj ERRU-së do të jenë në fokus të punës së institucionit edhe gjatë vitit 2019, si i vetmi mjet jo parësor, por i nevojshëm për të bërë të mundur zbatimin e ligjit nga shoqëritë UK dhe duke ndikuar kështu edhe në rregullimin e sektorit në tërësi.

1.4.5 Trajtimi i Ankesave të Konsumatorëve

Ligji nr. 8102 i atribuon Entit Rregullator të Ujit përgjegjësinë dhe detyrën për të mbrojtur konsumatorët nga çmimet monopol si dhe të gjejë një ekuilibër të drejtë midis interesave të tyre dhe operatorëve në sektorin e furnizimit me ujë.

Nga ana tjetër, nëpërmjet trajtimit të ankesave, mbrojtja e konsumatorëve është e orientuar drejt garantimit që shoqëritë UK të veprojnë në përputhje me rregulloren për furnizimin me ujë dhe kanalizimeve në zonën e shërbimit me kushtet e licencës së tyre, kushtet e përgjithshme të kontratës model duke siguruar kështu cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë e shërbimit.

Në funksion të detyrave të saj, ERRU nëpërmjet Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Konsumatorit për vitin 2018 ka shqyrtuar dhe trajtuar 39 ankesa, të ardhura kryesisht nga konsumatorë familjarë, 80% e tyre janë në drejtim të Ujësjetës Kanalizime Tiranë.

Natyra e ankesave të paraqitura pranë ERRU-së ka qenë kryesisht mbi “faturimin aforfe”, “zëvendësimin e shpeshtë të ujëmatësit dhe pa respektuar procedurat nga shoqëria UK”, “mbi faturimi”, “mosnjohjen e detyrimeve nga ana e konsumatorëve”, “problemet me kontratën për shërbime ujësjetës kanalizime” dhe “të tjera”.

Tabela 3 jep të detajuara sipas objektit ankesat e trajtuara nga ERRU gjatë vitit 2018

Tabela 3. Ankesat e Trajtuara nga ERRU gjatë vitit 2018

Nr.	Objekti i Ankesës	Nr. Ankesave	Nr. Ankesave të Zgjidhura
1	Faturimi Aforfe	20	3
2	Zëvendësimi i Ujëmatësit	2	1
3	Mos njohja e detyrimeve	8	2
4	Probleme me kontratat	5	1
5	Të tjera	4	3
TOTALI		39	10

Nga totali i të gjithë ankesave, 10 prej tyre kanë pasur një zgjidhje përfundimtare dhe të kënaqshme në favor të konsumatorit.

Ankesat e paraqitura në ERRU me objekt “faturimi aforfe” zënë numrin më të madh të ankesave edhe gjatë vitit 2018. Shqetësues mbetet fakti që shoqëritë UK nuk kanë respektuar normativat e miratuara në rastet e faturimit aforfe 4.5 m³/muaj/frymë për konsumatorët familjare, por kanë vijuar faturimin me normativat të miratuara me urdhër të brendshëm të organeve drejtuese të shoqërive UK në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi.

Problematikë tjetër që evidentohet në këto ankesa është se në të shumtën e rasteve shoqëritë UK kanë vijuar faturimin pa kryer asnjë lloj verifikimi edhe në rastet kur konsumatori nuk i ka shlyer detyrimet e tij për një kohë të gjatë. Zgjidhja e këtyre ankesave ka qenë një sfidë për rregullatorin për

shkak të periudhës së ankimuar si dhe procedurave që shoqëritë UK ndjekin për anulimin e faturave tatimore të ujit.

“Zëvendësimi i shpeshtë i ujëmatësit” është gjithashtu një objekt ankimimi. Nga këto ankesa, është konstatuar se shoqëritë UK nuk kanë respektuar procedurat e njoftimit të konsumatorit në rastet e zëvendësimit të ujëmatësit por njoftimi është kryer vetëm nëpërmjet faturës mujore.

“Mos njohja e detyrimeve ” është një ankesë e përsëritur nga një numër i konsiderueshëm konsumatorësh. Ky lloj ankimimi ka ardhur si pasojë e reformës së ndërmarrë në Sektorin e Ujit ku shoqëritë UK kanë evidentuar dhe kanë ndërmarrë hapa shtrënguese për shlyerjen e detyrimeve të mbartura të konsumatorëve. Megjithatë, është vënë re se jo në të gjitha rastet përgjegjësia i takonte vetëm konsumatorit për mosshlyerjen e detyrimit, por edhe procedurave të mangëta apo mosveprimet në kohë të shoqërive UK.

Reforma në Sektorin e Ujit e ndërmarrë përgjatë këtij viti, ka evidentuar një objekt të ri ankimi siç është “Problemi me kontratën për shërbime ujësjellës kanalizime”. Problematika e evidentuar në këto ankesa është lidhja e kontratës në mënyrë të njëanshme nga shoqëritë UK apo marrëdhënie të krijuara mes konsumatorëve dhe shoqërive UK duke mos pasur një marrëdhënie formalo - ligjore. Kjo lloj problematike ka sjellë më pas edhe detyrime të pashlyera nga ana e konsumatorëve.

Ankesa “Të tjera” kanë pasur në natyrën e tyre objekt ankimimi cilësinë e shërbimit apo respektimin e procedurave dhe përgjigjen në kohë nga ana e shoqërive UK ndaj nevojave të konsumatorëve.

Në të gjitha rastet ERRU, në rolin e ndërmjetësuesit, është përpjekur për t’u dhënë rekomandimet e duhura palëve, veçanërisht shoqërive UK për të respektuar të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën për shërbime ujësjellës kanalizime. Shoqëritë, ende nuk tregojnë seriozitetin dhe përgjegjësinë e duhur ndaj ankesave të konsumatorëve. Ato duhet të rrisin frymën e bashkëpunimit me to, si dhe të trajtojnë me kujdes ankesat e tyre.

Me qëllim përmirësimin e procesit të trajtimit të ankesave konform akteve ligjore në fuqi, ERRU ka vijuar punën gjatë vitit 2018 për hartimin e një Rregulloreje për trajtimin e ankesave të konsumatorëve, e cila ka kaluar për miratim në Komisionin Kombëtar Rregullator.

Përveç ankesave të paraqitura në mënyrë zyrtare, ERRU në zbatim të përgjegjësive dhe objektivave të saj ka ofruar asistencë dhe në dhënien e informacionit, shpjegimeve dhe konsultime verbale dhe me e-mail, telefon për të gjithë konsumatorët e interesuar. Ndërgjegjësimi i konsumatorëve për të drejtat e tyre që lidhen me shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime, si dhe zhvillimi me seriozitet dhe përgjegjësi i seancave dëgjimore me publikun, kanë rritur besimin në rolin e ERRU-së në mbrojtje të interesave të tyre, gjë që ka sjellë natyrshëm rritjen e ndjeshme të numrit të ankesave pranë ERRU-së.

ERRU e ka në fokus të objektivave të saj rritjen e angazhimit në ndihmë të konsumatorëve, për të gjetur një zgjidhje sa më të drejtë për ankesat e tyre.

1.4.6 Monitorimi i Performancës së Sektorit dhe Shoqërive UK

Nisur nga objektivi për të pasur një sektor financiarisht të qëndrueshëm, i cili ofron shërbime me cilësinë më të mirë të mundshme për konsumatorët, monitorimi dhe vlerësimi i performancës së operatorëve të shërbimit UK dhe sektorit në tërësi merr një rëndësi të veçantë.

Rezultatet e monitorimit të shoqërive UK janë publikuar në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet Raportit të Performancës për Shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime që hartohet nga ERRU që nga viti 2011.

Monitorimi i sektorit UK dhe publikimi i raportit të performancës ka për qëllim transparencën me të gjithë aktorët e interesuar, përfshirë konsumatorët, që të shohin dhe vlerësojnë performancën e operatorit të tyre lokal, si dhe problematikat e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve dhe rekomandimet për zgjidhjen e tyre.

Nëpërmjet publikimit të këtij raporti synohet nxitja e të gjithë aktorëve në sektor si, operatorët, kryetarët e bashkive, këshillat administrative, konsumatorët, mediat si dhe vendimmarrësit politikë vendorë dhe qendrorë për t'u angazhuar në një dialog konstruktiv mbi sfidat aktuale të sektorit dhe ato në të ardhmen.

Monitorimi jep mundësi për një vlerësim korrekt të performancës së çdo operatori dhe vendosjen e objektivave sfiduese dhe të arritshme shoqëruar me plane veprimi për arritjen e tyre.

Monitorimi dhe vlerësimi krahasues i performancës së shoqërive ujësjetllës kanalizime dhe sektorit UK, deri më tani është bazuar në 10 tregues kryesorë të performancës të miratuar nga KKRR. ERRU duke pasur parasysh zhvillimet në sektor, krahas ndryshimeve në Metodologjinë e Vendosijes së tarifave, është duke rishikuar treguesit e performancës që do të monitorohen. Në metodologjinë e rishikuar të vendosjes së tarifave është duke u seleksionuar një gamë e treguesve të performancës më të përdorshëm dhe realisht të vlerësueshëm e të monitorueshëm, të cilët kontribuojnë për një analizë dhe aprovim sa më objektiv të tarifave që propozohen nga shoqëritë UK.

Theksohet fakti që në praktikën e mëparshme, hartimi dhe botimi i këtij raporti realizohej jo më parë se fundi i tetorit të vitit pasardhës. Botimi i tij në këtë afat nuk kishte vlerë reale praktike të marrjes parasysh dhe zbatimit në kohë të rekomandimeve që jepen në raport për vitin në vazhdim. ERRU, me angazhim maksimal arriti që ky raport për vitin 2018 të hartohet dhe publikohet në fund të Qershorit 2018.

Të dhënat për hartimin e raporteve merren nga Njësia e Monitorim Benchmark-ut pranë AKUM. Duke pasur parasysh problemet e saktësisë së të dhënave si dhe të lidhjes organike dhe direkte të veprimtarisë së ERRU-së me shoqëritë UK, ERRU e ka ngritur si shqetësim dhe njëkohësisht rekomandon të konsiderohet mundësia që kjo njësi të kalojë pranë ERRU-së.

*Një rregullim i mirë i sektorit ka nevojë për informacion të besueshëm dhe një monitorim të vazhdueshëm. Monitorimi krijon mundësi për të bërë një vlerësim më të saktë të performancës së çdo shoqërie dhe për të vendosur objektiva sa më realiste, duke pasur parasysh kapacitetet aktuale të tyre. Për ERRU, **saktësia dhe besueshmëria e të dhënave** është tashmë një nga sfidat dhe fokuset e punës se saj për të ardhmen.*

Në zbatim të ligjit nr. 8102, ERRU kontrollon subjektet e licencuara për zbatimin e këtij ligji, respektimin e kushteve të licencës dhe përdorimin e tarifave të ujit për konsum publik.

Rezultatet e këtyre kontrolleve janë një burim tjetër informacioni në lidhje me monitorimin e performancës së operatorëve, të cilat gjatë vitit 2018 janë realizuar kryesisht sipas tematikave të mëposhtme:

- licencimi i operatorëve dhe zbatimi i kushteve të licencës,
- zbatimi i tarifave të miratuara nga ERRU dhe tarifave për shërbimet e tjera,
- pagesat rregullatore
- hartimi i bilancit të ujit dhe menaxhimi i humbjeve
- investimet në sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura,

Gjithsesi rezultatet e monitorimit të shoqërive UK dhe të sektorit në përgjithësi trajtohen me tej në një kapitull të veçantë.

1.4.7 Përmirësimi i Standardeve në Sektorin UK Nëpërmjet Instrumenteve Rregullatore

Një nga kompetencat e KKRR është miratimi i rregullave dhe nën akteve për të ndihmuar në ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të tij të parashikuara në ligj. Në këtë drejtim, ERRU gjatë vitit 2018 ka vijuar me punën për të përmirësuar instrumentet rregullatore që lidhen kryesisht me aplikimin për ndryshimin e tarifave. Në këtë kuadër ERRU ka rishikuar dokumentet e mëposhtme;

“Metodologjia e Vendosjes së Tarifave”. Në vijim të ngritjes së grupit të punës në fund të vitit 2017 për rishikimin e Metodologjisë së Vendosjes së Tarifave, Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 18, datë 22.03.2018 vendosi “Për fillimin e procedurës për ndryshimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave”. Ndryshimet konsistojnë kryesisht në:

- Rishikimin e metodologjisë, duke marrë parasysh realitetin e operatorëve në sektor nisur nga fakti se shumica e tyre janë të paqëndrueshme financiarisht, si dhe nga ana tjetër operatorë që kanë një performancë financiare dhe operative shumë të mirë, të cilat aplikojnë për ndryshimin e tarifave me qëllim akumulimin e të ardhurave për shlyerjen e kredive dhe për të mbuluar nevojat për investime;
- Rishikimin e gamës së treguesve kryesorë të performancës të përmendura më sipër;
- Domosdoshmërinë e përgatitjes së planeve të biznesit 5 vjeçar për të hartuar një propozim për tarifa të reja, konsistent e të qëndrueshëm në kohë, të paktën për perspektivën pesë vjeçare të aktivitetit të shoqërisë, si dhe detyrimin që shoqëritë UK të paraqesin një raport vjetor performance pranë ERRU-së, në përputhje me planin e biznesit dhe zbatimit të tarifave të aprovuara nga ERRU;
- Nevojën për rishikimin e afatit të aplikimit (data 30 qershor i vitit aktual). Aplikimi të jetë i lirë për t'u bërë në çdo moment të vitit me kushtin që dokumentacioni ligjor, teknik dhe ekonomik të jetë i plotë;
- Rishikimin e skemës së procesit të aplikimit, ndryshimi dhe thjeshtimi i saj.

Nisur nga sa më sipër, në fund të muajit dhjetor, Grupi i Punës konkludoi në draftin, i cili iu dërgua për shqyrtim nga KKRR. Miratimi i metodologjisë së vendosjes së tarifave, i rishikuar, është planifikuar të përfundojë gjatë vitit 2019. Arsyeja kryesore që KKRR ka vendosur ta përfundojë këtë proces gjatë vitit 2019 është sepse Metodologjia e Vendosjes së tarifave është gjithashtu një nga tre temat kryesore që WAREG (Shoqata Europiane e Rregullatorëve), (ku ERRU është anëtare) ka planifikuar të trajtojë, si dhe përshtatja me kërkesat e ligjit të ri për sektorin e ujit që pritet të miratohet brenda vitit 2019.

“Rregullore për Organizimin e Seancës Dëgjimore me Publikun” u miratua me datë 21.09.2018, miratimi i saj erdhi në vijim të përmirësimit dhe nevojës për rregulla të qarta dhe të zbatueshme në organizimin e seancës dëgjimore.

Rregullorja bazohet në eksperiencën e zhvillimit të seancave dëgjimore gjatë të cilave është konstatuar se udhëzuesi i mëparshëm nuk ishte i plotë në drejtim të orientimit për zhvillimin e një seance dëgjimore praktike dhe efikase për një komunikim dhe përfitim të opinionit publik në lidhje me problematikat e shërbimeve, si edhe të tarifave që operatori propozon të aplikojë.

Rregullorja e seancës dëgjimore është pasuruar më tej edhe me një model prezantimi, i cili duhet të përmbajë në mënyrë të përmbledhur dhe lehtësisht të kuptueshme nga publiku, informacionin që shoqëria duhet të prezantojë në justifikim të tarifave të reja të propozuara. Risi e kësaj rregulloreje është gjithashtu që prezantimi i seancës dëgjimore bëhet pasi miratohet më parë nga ERRU në mënyrë që konsumatorëve t’iu prezantohet informacion sa më i saktë dhe i kuptueshëm i tij.

1.5 Bashkëpunimi dhe Marrëdhëniet Ndërinstitucionale të ERRU-së

Edhe për vitin 2018, ERRU i kushtoi një vëmendje të veçantë bashkëpunimit me institucionet brenda vendit dhe ato ndërkombëtare si një hallkë e rëndësishme e përcjelljes së qëndrimit të rregullatorit në zhvillimin e sektorit ujësjellës kanalizime dhe nga ana tjetër e përfitimit të eksperiencave dhe modeleve më të mira rregullatore.

1.5.1 Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare

1.5.1.1 Me Kuvendin e Shqipërisë

Bashkëpunimi me Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2018 ka konsistuar me informimin e përvitshëm të veprimtarisë institucionale të rregullatorit si dhe të gjendjes së sektorit të ujit nëpërmjet raportimit në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit. Gjithashtu në vijim të zbatimit të mekanizmit ndërinstitucional për forcimin e sistemit të monitorimit të të dhënave dhe rekomandimeve të institucioneve të pavarura, bashkëpunimi me Kuvendin ka vazhduar me takimet e organizuara nga Kryetari i Kuvendit si dhe me raportimin periodik mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në rezolutën e Kuvendit për vitin 2018.

1.5.1.2 Me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Në bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë në kuadër të riorganizimit të sektorit të ujit dhe implementimit të reformës së ndërmarrë nga Qeveria Qendrore. ERRU ka kontribuar me propozime për qasjen e vazhdimësisë së reformës së ujit si dhe ka pasur një rol të rëndësishëm në rishikimin e dokumenteve sektoriale.

Në këtë kuadër, ERRU është pjesë e grupeve ndërinstitucionale të punës të krijuara nga kjo ministri për:

- ✓ Hartimin e Strategjisë Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve sipas urdhrit Nr. 775, datë 06.11.2018;
- ✓ Hartimin e ligjit të ri të funksionimit të sektorit ujësjellës kanalizime sipas urdhrit Nr. 581, datë 18.07.2018;

Në të dyja grupet e punës, ERRU ka përcjellë qëndrimin në lidhje me problematikat në sektorin e ujit, nevojat për ndërhyrje, të cilat duhet të gjejnë rregullim në këto dokumente sektoriale.

Në veçanti për hartimin e ligjit të ri, ERRU konsideron rishikimin e ligjit Nr. 8102 për kuadrin rregullator (në fakt për të gjithë sektorin e ujësjellës kanalizimeve), që është pjesë e detyrimeve që ka ERRU nga Rezoluta e Kuvendit për aktivitetin e saj për vitin 2018.

Në vija të përgjithshme ERRU në projekt-dokumentin për rishikimin e ligjit nr. 8102 për kuadrin rregullator ka propozuar ndryshimet e mëposhtme:

- Saktësimin e kompetencave të ERRU-së si institucioni që monitoron shoqëritë UK, dhe në përgjithësi sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura, shmangien e mbivendosjes së kompetencave me AKUM, si dhe përfshirjen në strukturën e saj të njësisë së benchmark që aktualisht ndodhet në AKUM.
- Anëtarët dhe Kryetari i Komisionit Kombëtar Rregullator të ERRU-së, të emërohet nga Kuvendi i Shqipërisë.
- Riformulimin e kërkesave me karakter mjaft të përgjithshëm për profilin e anëtarëve të Komisionit duke i saktësuar ato në përputhje me kompetencat dhe fushën e aktivitetit të institucionit të ERRU-së në sektorin e ujit.
- Mandati i anëtarëve të Komisionit të jetë 5 vjeçar në vend të atij aktual 4 vjeçar.
- Përmirësimi i disa elemente jo thelbësore të pavarësisë aktuale financiare të institucionit kryesisht për tepricat e buxhetit
- Përmirësimi i aspekteve që lidhen me përmbushjen e disa kërkesave shtesë nga shoqëritë UK gjatë procesit të licencimit, dhe sidomos në atë të tarifave.
- Përmirësimi në drejtim të efektivitetit dhe zbatimit real në praktikë të neneve që lidhen me kundërvajtjet e shoqërive UK për shkeljet e ndryshme ndaj detyrimeve të diktuar në licencën e lëshuar nga ERRU, si dhe të tarifave të aprovuara prej saj.

1.5.1.3 Me Autoritetin e Konkurrencës

Në përmbushje të plotë të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, ERRU intensifikoi bashkëpunimin dhe marrëdhëniet dy palëshe me Autoritetin e Konkurrencës. Në datën 17.10.2018 dy institucionet nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi me qëllim bashkëpunimin mes tyre për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive dhe garantimin e mbrojtjes e interesave publike dhe krijimin e një mjedisi transparent ligjor në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

Gjatë vitit 2018, ERRU, ka bashkëpunuar ngushtësisht me Autoritetin e Konkurrencës veçanërisht sa i takon çështjes së tarifave në sektorin ujësjellës kanalizime, duke kërkuar vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt vendim për miratimin e nivelit të ri tarifor për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

Theksohet fakti që analiza e projekt vendimeve të ERRU-së nga Autoriteti i Konkurrencës kryhet brenda një afati kohor të përcaktuar dhe me prezencën e përfaqësuesve të ERRU-së për argumente dhe/ose detaje që mund të kërkojnë në lidhje me tarifa të reja të aprovuara për shoqëritë UK.

1.5.1.4 Me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor

Në vitin 2018, ERRU mori iniciativën për nevojën e ndryshimeve të nevojshme ligjore që duhet të ndërmerren për përmirësimin e rregullave në marrjen e akt-miratimit higjieno - sanitar nga shoqëritë ujësjellës kanalizime që nga ana institucionale ka si aktorë kryesorë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës dhe Inspektoratin Sanitar Shtetëror. Për këtë qëllim, ERRU ka marrë pjesë në grupin e punës me përfaqësues nga MIE dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Inspektorati Sanitar Shtetëror, Drejtoritë e Shëndetit Publik dhe ka përcjellë propozimet për ndryshimet e nevojshme të nën akteve ligjore, proces i cili vazhdon dhe është nën monitorimin nga afër të specialistëve të Kabinetit të Kryeministrit.

Theksohet fakti se këto akte nënligjore lidhen me eliminimin e problemeve që hasen në praktikë në zbatim të kërkesave që rrjedhin nga VKM nr. 379, dt. 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores së cilësisë së ujit të pijshëm” për objektet e furnizimit me ujë, për të përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të saktë mënyrën e dhënies së Akt Miratimit Higjieno Sanitar pa cënuar cilësinë e ujit të pijshëm dhe në funksion të garantimit të shëndetit publik.

1.5.2 Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare

Krijimi i vazhdueshëm i një eksperience ndërkombëtare apo njohja me një qasje tjetër rregullatore ka qenë në fokusin e ERRU-së edhe për vitin 2018. Këtu mund të përmendim aktivitetin dhe rolin e ERRU-së në anëtarësimin dhe pjesëmarrjen aktive në organizatat ndërkombëtare, workshop-eve apo konferencave ndërkombëtare në fushën e ujit.

1.5.2.1 ERRU Anëtare e Organizatave Europiane dhe Ndërkombëtare

Enti Rregullator i Ujit është anëtar me të drejta të plota e shoqatës së rregullatorëve evropiane të ujit **WAREG**. Viti 2018 shënoi konsolidimin e plotë të këtij rrjeti me nënshkrimin e statutit të tij me qëllimin kryesor promovimin e një bashkëpunimi të ngushtë rregullator me baza vullnetare. Ky statut u shoqërua me miratimin e rregullores së brendshme të këtij rrjeti dhe është në fazën finale të miratimit të planit financiar 3 vjeçar.

Theksojmë faktin së ERRU e sheh me përparësi pjesëmarrjen aktive në këtë organizatë ku ofrohen mundësi të mëdha bashkëpunimi dhe shkëmbimi direkt të eksperiencës për argumentet që prekin rregullatorët, veçanërisht rregullatorët ekonomikë si ERRU. Ndër tematikat kryesore të trajtuara deri tani përmendim, përbalueshmërinë e tarifave për konsumatorët, monitorimi i regjimit të investimeve kapitale, rishikimi i direktivave kryesore të ujit të pijshëm dhe ato të trajtimit të ujërave të ndotura.

Gjatë vitit 2018, ERRU ka marrë pjesë aktive në të tre mbledhjet e Asamblesë së WAREG të cilat kanë konsistuar si më poshtë:

- WAREG, Mbledhja 14-të e Asamblesë në Gent, Belgjikë më 31 janar 2018. Tematika “Përbalueshmëria e Tarifave nga Konsumatorët”.
- WAREG, Mbledhja e 15-të e Asamblesë në Sofje, Bullgari më 8 maj 2018. Anëtar i Task Forcës “Për Investimet Kapitale në Sektorin e Ujit”. Prezantimi: Regjimi i Monitorimit të Investimeve Kapitale, Rasti i Shqipërisë.
- WAREG, Mbledhje e 16-të e Asamblesë në Budva, Mal i Zi, 25-26 shtator 2018. Anëtar i Task Forcës “Për Rishikimin e Direktivës Europiane për Trajtimin e Ujërave të Ndotura”.

Përveç pjesëmarrjes aktive nga përfaqësues të niveleve të larta të ERRU-së në takimet e asamblesë apo në takime bilaterale të zhvilluara, kjo organizatë jep mundësi edhe për trajtime të çështjeve të tjera mjaft specifike që mund të shkëmbehen online. Përmenden raste të trajtimit të eksperiencave për probleme të raportit të kostove dhe tarifave për shërbimin e grumbullimit të ujërave të ndotura me ato të trajtimit të tyre, kostove fikse të shërbimeve, probleme të marrëdhënieve kontraktuale rregullatore, si dhe për çështje që mund të jenë risi për rregullatorë të ndryshëm.

Edhe për këtë vit, ERRU vijoi bashkëpunimin në nivel përfaqësimi me **Programin e Ujit për Rajonin e Danubit** të mbështetur nga Banka Botërore dhe Shoqata Ndërkombëtare e Shoqërive Ujësjiellës Kanalizime. Ky program organizoi më datë 2 - 3 maj 2018 konferencën vjetore të Danubit për Ujin në Vjenë të Austrisë me tematikë kryesore: “Sigurimin e një shërbimi të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve”. Konferenca, me përfaqësues të sektorit të ujit nga më shumë se 15 vende të ndryshme diskutoi progresin, sfidat dhe veprimet e nevojshme që duhet të ndërmerren në të ardhmen për një shërbim të qëndrueshëm për të gjithë rajonin e Danubit.

Po në kuadër të këtij programi, më 22-23 mars 2018, ERRU mori pjesë në Seminarin e Rajonit të Danubit për Benchmarking në Zhabjak, Mal i Zi në të cilin u diskutuan rezultatet e raportit ndërkombëtar të benchmarkut, ku ERRU mori pjesë me prezantimin: “Roli dhe Përgjegjësitë e Rregullatorit , sfidat e Reformës së Sektorit të Ujit në Shqipëri”.

Programi gjatë vitit 2018 mbështeti gjithashtu organizimin e një vizite studimore në Lisbonë të Portugalisë në datat 8 - 12 Tetor 2018 me përfaqësues nga Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Shqipëria, e cila kishte përfaqësues edhe nga Enti Rregullator i Ujit. Qëllimi i kësaj vizite ishte prezantimi i eksperiencës mjaft të suksesshme të Portugalisë në reformën e ndërmarrë në sektorin e Ujit, roli i rregullatorit në promovimin e sektorit të ujit dhe faktorët që ndikojnë tek efica e një rregullatori. Gjithashtu një rëndësi të veçantë ju dedikua prezantimit me shembuj pozitivë të procesit të agregimit në sektorin e ujit të Portugalisë si dhe hapat që ndihmojnë drejt një agregimi të suksesshëm.

Në prill të vitit 2018, ERRU mori pjesë në takimin e radhës së Rrjetit të Rregullatorëve Ekonomikë (NER) në Paris të Francës, të krijuar nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). Tematika e këtij viti ishte diskutimi mbi të ardhmen e rregullimit dhe roli i rregullatorëve në një epokë të ndryshimeve të shpejta teknologjike. Gjithashtu diskutimi u fokusua se si kapacitetet dhe mekanizmat e bashkërendimit të rregullatorit duhet të përshtaten me zhvillimin e shpejtë që pësojnë sektorët.

Si çdo vit, ERRU i dha rëndësinë e duhur dhe mori pjesë në mënyrë aktive me prezantime dhe moderime në konferencën e përbashkët ballkanike të organizuar nga SHUKALB dhe SHUKOS. Konferenca iu dedikua "Ujit dhe Natyrës", një temë mjaft e nevojshme për ndërgjegjësimin e ruajtjes së burimeve ujore. ERRU mori pjesë me dy prezantime me tematikat përkatësisht:

- Metodologjia e vendosjes së tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizimeve, sfidat -rishikimi
- Konsumatorët dhe angazhimi i tyre në shërbimet e ujësjellës kanalizimeve

1.5.2.2 Marrëdhëniet Bilaterale të ERRU-së

Krahas aktiviteteve me pjesëmarrje të gjerë të institucioneve ndërkombëtare të fushës së ujit, ERRU zhvillon mjaft aktivitete me karakter bilateral bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit, kryesisht me rregullatorin e Kosovës (ARRU), rregullatorin e Skocisë (WICS), dhe sidomos me rregullatorin e Italisë (ARERA).

Gjatë vitit 2018 në kuadër të marrëdhënieve bilaterale ERRU zhvilloi takimin vjetor me rregullatorin e Kosovës për shkëmbimin e eksperiencës rregullatore mbi tarifën, vlerësimin të performancës dhe procesit të licencimit. E veçanta e këtij viti ishte pjesëmarrja në këtë takim e përfaqësuesve të nivelit të lartë të rregullatorit të Maqedonisë (ERC), një rregullator i krijuar rishtazi i cili shprehu nevojën për bashkëpunime të mëtejshme me rregullatorët e rajonit të Ballkanit.

Gjithashtu, krahas rinovimit të marrëveshjes dypalëshe me rregullatorin e Skocisë, në Qershor 2018 ERRU mori pjesë në workshopin e organizuar nga ky rregullator në Edinburg të Skocisë mbi rolin dhe përfshirjen e konsumatorit në shërbimet ujësjellës kanalizime, si dhe zhvilloi disa vizita pune pranë këtij rregullatori. Në Skoci, konsumatorët nëpërmjet Forumit të Konsumatorëve marrin pjesë në mënyrë aktive në diskutimin dhe aprovimin e biznes planit të shoqërisë ujësjellës kanalizime. Ai konsiderohet si partner i rregullatorit në oponencë për shoqërinë për nxitjen e performancës së saj, eksperiencë, e cila duhet gradualisht të fillojë të aplikohet edhe në vendin tonë.

Në mars 2018, ERRU zhvilloi një vizitë treditore pune dhe trajnimi pranë rregullatorit multi sektorial të Italisë, (ARERA), një rregullator ekonomik mjaft i ngjashëm me ERRU-në. Subjekte të trajnimit të stafit të sektorit teknik dhe të tarifave të ERRU-së ishin elementet e procedurave dhe detajeve praktike të analizës që zhvillon rregullatori i Italisë për vlerësimet e propozimeve dhe aprovimit për tarifa të reja, sidomos kur kërkohet të mbulohen me tarifa edhe nevojat për investime në sektor. Gjithashtu gjatë trajnimit një ditë e veçantë iu dedikua edhe problemit të humbjeve dhe planeve të veprimit për menaxhimin dhe uljen e tyre nga shoqëria e ujësjellësit e Milanos.

1.6 Transparenca dhe Marrëdhëniet e ERRU-së me Publikun dhe Median

Transparenca është një faktor që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmbushjen e misionit të ERRU, sigurimin e të gjithë konsumatorëve në Shqipëri, që ofrujesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.

Për këtë arsye, ERRU punon vazhdimisht për të rritur transparencën dhe llogaridhënien ndaj publikut. Programi i transparencës siguron publikun të aksesojë lehtësisht informacionin që institucioni prodhon dhe disponon në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Gjatë vitit 2018, dymbëdhjetë (12) kërkesa për informacion iu drejtuan ERRU, të cilat u trajtuan brenda afateve ligjore apo u përcollën tek institucionet përgjegjëse në rastet kur Enti nuk e dispononte informacionin e kërkuar.

ERRU planifikon që gjatë vitit 2019 të rishikojë Programin e Transparencës, me qëllim përditësimin dhe përfshirjen në të të sa më shumë informacioneve dhe të dhënash që mund të jenë në interes të publikut.

Edhe gjatë vitit 2018, në mënyrë periodike është punuar për përditësimin e faqes zyrtare të ERRU-së, duke ofruar një pasqyrë sa më të saktë të informacioneve dhe zhvillimeve të rregullatorit. Një nga prioritetet kryesore ka qenë dhe mbetet përditësimi i të gjitha vendimmarrjeve të ERRU-së, publikimi i akteve nënligjore të miratuara nga Komisioni Kombëtar Rregullator si dhe statusin aktual që ka çdo shoqëri UK mbi licencën dhe tarifën e miratuara;

Gjithashtu, komunikimi me mediat është realizuar nëpërmjet artikujve të botuar në gazeta apo revista ekonomike, si një komunikim i drejtpërdrejtë dhe transparent mbi problemet dhe zhvillimet që pëson sektori i ujit.

1.7 Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së

1.7.1 Të Ardhurat

Burimet e financimit të aktivitetit e veprimtarisë së ERRU, sikurse përcaktohet në ligjin nr. 8102, janë pagesat e rregullimit, të detyrueshme për operatorët që operojnë në sektor. Ato përbëhen nga pagesat rregullatore vjetore dhe pagesat për licencime të vendosura nga vetë rregullatori. Enti Rregullator i Ujit, në përputhje me ligjin, ka nënshkruar kontrata me operatorët për aplikimin e tarifave të miratuara, ku është përcaktuar pagesa rregullatore vjetore dhe afatet e likuidimit.

Detyrimi vjetor i pagesave rregullatore për vitin 2018, mbështetur në kontratat me shoqëritë, është në shumën **48,446,450 lekë**. Kjo vlerë përfshin vetëm pagesat rregullatore vjetore të shoqërive që operojnë me tarifa të miratuara nga ERRU. Në mbyllje të vitit 2018 rezultojnë 19 shoqëri, të cilat nuk operojnë me tarifa të miratuara nga ERRU e për rrjedhojë nuk kanë kontrata si dhe pagesë rregullatore, që kryesisht janë shoqëri UK të vogla që nuk influencojnë në mënyrë të konsiderueshme në buxhetin e ERRU-së.

Të ardhurat totale të realizuara gjatë vitit 2018 janë në shumën **80,870,363 lekë**, prej të cilave **79,807,426 lekë** janë nga pagesat rregullatore, **680,000 lekë** nga pagesat për licencimet dhe **382,937 lekë** të ardhura të tjera, që jepen në Tabelën 4.

Tabela 4. Realizimi i të Ardhurave Sipas Zërave

Nr.	Emërtimi i të Ardhurave	Vlera
1	Nga Pagesat Rregullatore të Prapambetura	31,360,976
2	Nga Pagesat Rregullatore të vitit 2018	48,446,450
3	Nga Pagesat e Licencimit	680,000
4	Të tjera	382,937
Totali		80,870,363

Detyrimi i prapambetur i shoqërive UK krahasuar me atë të vitit paraardhës është ulur me 36% ose **31,360,976 lekë**. Pagesat rregullatore kumulative të pashlyera të shoqërive UK në fund të vitit 2018 rezultojnë në shumën **55,278,290 lekë**.

Të ardhurat e realizuara në vitin 2018 garantuan tërësisht mbështetjen financiare për ushtrimin e aktivitetit vjetor të Entit, duke mbuluar tërësisht shpenzimet vjetore të tij. Në vijimësi KKRR ka treguar kujdes të veçantë në përcaktimin e pagesave rregullatore vjetore në përpjesëtim të drejtë me të ardhurat e operatorëve që operojnë në sektorin UK dhe gjithashtu të mjaftueshme për përballimin e shpenzimeve operative vjetore të ERRU. Aktualisht pagesat rregullatore variojnë nga 0.6-0.8 % të të ardhurave vjetore të parashikuara të operatorëve.

ERRU gjatë këtij viti ka ndjekur nga afër mundësinë e realizimit të pagesës rregullatore të akumuluar dhe të papaguar duke e shtrirë atë brenda një afati kohor të arsyeshëm, gjë e cila është përfshirë në kontratën përkatëse me shoqëritë ujësjellës kanalizime. Mbledhja e detyrimeve të prapambetura ka rezultuar pozitive veçanërisht për shoqëritë e mëdha UK Tirana, UK Durrës dhe UK Fier që përbëjnë pjesën më të madhe të detyrimit të akumuluar.

Shlyerja e detyrimeve të pagesës ndaj ERRU-së për licencimin ka qenë e rregullt, si për shkak të vlerës së vogël të saj edhe si detyrim paraprak i shoqërive UK për t'u licencuar.

ERRU synon që në rishikimin e ligjit 8102 për kuadrin rregullator detyrimin për pagesën rregullatore ta saktësojë në kritere më të drejta duke u bazuar jo në të ardhurat bruto vjetore nga aktivitetet e shoqërisë, por në sasinë vjetore të ujit të prodhuar prej tyre. Duke patur parasysh që shoqëri të ndryshme aplikojnë tarifa të ndryshme shërbimi, kriteri i të ardhurave nuk i vë në kushte të njëjta detyrimi të gjitha shoqëritë, ndërkohë që kriteri i sasisë vjetore të ujit të prodhuar eliminon këtë "pabarazi", si dhe stimulon uljen e Ujit Pa të Ardhura nga shoqëritë UK.

1.7.2 Shpenzimet Operative

Administrimi i vlerave materiale e monetare në ERRU kryhet në përputhje të plotë me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik" dhe rregullores së brendshme të ERRU "Për menaxhimin e aktiveve". Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së propozohet nga ajo vetë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura".

Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së, për vitin 2018, është miratuar me VKM nr. 26, datë 17.01.2018, "Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2018, të Entit Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura". Në total plani i miratuar është në shumën **49,648,000 lekë** dhe i detajuar në katër zërat kryesorë: paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, shërbime e furniturë dhe investime, në raporte që paraqiten në figurën 3, si më poshtë:




Figura 3. Struktura e Planit të Shpenzimeve Operative të Vitit 2018

KKRR me vendimin nr. 23, datë 24.01.2018, ka detajuar planin vjetor të miratuar nga Këshilli i Ministrave në artikuj të shpenzimeve në përputhje me nevojat e domosdoshme për të garantuar mbështetjen logjistike për përmbushjen e objektivave vjetorë të ERRU-së, zhvillimin e veprimtarive të parashikuara dhe funksionimin normal të veprimtarisë së përditshme.

Në planin vjetor të Entit, shpenzimet për personelin (paga + sigurime shoqërore) përbëjnë 65% të totalit të planit vjetor të shpenzimeve dhe 35% janë shërbime e furniturë dhe investime. Shpenzimet buxhetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit të veprimtarisë vjetore të Entit gjatë vitit 2018, janë në shumën **44,162,369 lekë, ose 89 % të fondit të planifikuar të shpenzimeve operative**. Realizimi në këtë përqindje ka ardhur kryesisht nga influenca e mosrealizimit në fondet e parashikuara në zërin shërbime e furniturë.

Shpenzimet e kryera të detajuara dhe në përqindje të realizimit paraqiten si më poshtë:

- 26,038 mijë lekë, shpenzime për pagat e punonjësve. (94%)
- 4,104 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore. (88%)
- 6,845 mijë lekë, shpenzime për shërbime e furniturë. (68%)
- 7,176 mijë lekë, shpenzime për investime. (98%)

Plani i miratuar i shpenzimeve operative të ERRU krahasuar me shpenzimet e realizuara paraqitet në formë grafike në figurën 4.




Figura 4. Plani i Shpenzimeve të Miratuara nga KM me Shpenzimet e Realizuara

Arsyeja kryesore e uljes së shpenzimeve në krahasim me ato të planifikuara është se fondi i planifikuar në zërin “shërbime e furniturë” është realizuar në masën 68% kryesisht nga ulja e zërave shpenzime në energji elektrike, shpenzime për aktivitete dhe mirëmbajtje mjete transporti.

Në mbyllje të vitit, gjendja e mjeteve financiare të disponueshme në llogarinë bankare të Entit, garanton plotësisht projekt buxhetin e vitit 2019 dhe teprica do të derdhet në buxhetin e shtetit pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.

2 Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për Vitin 2018

Më poshtë jepet në mënyrë të detajuar realizimi i secilit rekomandim të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për ERRU për vitin 2018.

- ❖ *Duke e konsideruar reformën në sektorin e ujit si një reformë jetike për sektorin e ujësjellës - kanalizimeve e cila ka kërkuar një fazë relativisht të gjatë përgatitore, ERRU të bashkëpunojë me gjithë institucionet dhe aktorët e kësaj reforme e në mënyrë të veçantë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, për të bërë të mundur suksesin e kësaj reforme.*

ERRU ka dhënë rekomandimet përkatëse pranë MIE në lidhje me draftin e Kontratës së Performancës ndërmjet AKUM (MIE) dhe bashkive. Siç citohet edhe në nënkapitullin e reformës, ERRU ka dhënë gjithashtu opinionet dhe rekomandimet e saj mbi vazhdimësinë dhe efektshmërinë e reformës së sektorit të ujit.

- ❖ *Në kuadër të reformës në sektorin e ujit, si dhe të kërkesave për një menaxhim bashkëkohor të sektorit UK, të përmirësojë metodologjinë aktuale të llogaritjes së tarifave duke patur si bazë vlerësimi performancën tekniko-ekonomike të shoqërive dhe objektivat për përmirësimin e tyre në përputhje me planin e biznesit 5-vjeçar të shoqërisë.*

Grupi i Punës ka përfunduar Draftin e rishikimit të metodologjisë së tarifave bazuar në nevojën dhe domosdoshmërinë e përmirësimit të saj me ndryshimet që kanë ndodhur në sektor dhe e ka paraqitur atë në komision për shqyrtim. Drafti pritet të pasurohet edhe me analizën dhe eksperiencat e rregullatorëve të tjerë të Europës, si një nga tre tematikat kryesore që WAREG ka planifikuar të trajtojë gjatë vitit 2019.

- ❖ *Përmes të gjitha instrumenteve ligjore që disponon, të kërkojë nga shoqëritë UK që të kenë përparësi të punës së tyre rritjen e normës së arkëtimit, e cila ka një rënie prej 8% krahasuar me një vit më parë, rritjen e efikasitetit të stafit, mbulimit të kostove O&M, uljen e nivelit të humbjeve, i cili vijon të mbetet 65%, nivel i cili mbetet tepër i lartë dhe përbën një shqetësim kryesor për sektorin UK; evidentimi, eliminimi apo legalizimi i lidhjeve të paligjshme të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK.*

ERRU, gjatë vlerësimit të propozimeve të shoqërive UK për tarifa të reja gjatë vitit 2018 i ka kushtuar një rëndësi të veçantë vlerësimit dhe vendosjes së objektivave ambicioze sidomos në lidhje me normën e arkëtimit, mbulimit të kostove dhe Ujit Pa të Ardhura (humbjeve). Gjatë këtij viti janë aprovuar dhe vendosur objektiva për treguesit kryesorë të mësipërm të performancës për shoqëritë: UK Malësi e Madhe, U Gramsh, UK Skrapar, UK Maliq, UK Vau Dejës dhe UK Librazhd Prrenjës

- ❖ *Të tregohet efikasitet dhe kujdesshmëri në politikën e miratimit të rritjes së tarifave, duke e parë atë të lidhur ngushtë me rritjen e performancës së operatorëve, uljes së shpenzimeve,*

rritjen e efikasitetit menaxhues dhe përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorit, si dhe të monitorojë nga afër nëse tarifat e miratuara, aplikohen drejtë nga shoqëritë UK.

Gjatë analizës dhe procesit të miratimit të tarifave, ERRU analizon hollësisht kostot që merren në konsideratë për t'u përballuar nga tarifa, por nga ana tjetër analizon dhe treguesit e punës që lidhen me menaxhimin e shoqërisë. ERRU gjatë analizës së kostove ka planifikuar që në rastet e aplikimeve për tarifa të reja shoqëritë UK të japin shpjegime me kostot analitike të shpenzimeve të saj.

Nga ana tjetër, ERRU ka kryer inspekte për monitorimin nga afër të tarifave të miratuara dhe ka vendosur penaltete (gjoba) në rastin e mosrespektimit të tyre si në rastin e shoqërisë UK Tropolje dhe UK Dibër.

- ❖ *Të vijojë përpjekjet dhe bashkëpunimin për hartimin sa më parë të ligjit të ri, i cili bëhet akoma më i nevojshëm si në kuadrin e reformës së sektorit të ujit ashtu edhe me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Furnizimit me ujë dhe kanalizime dhe direktivat e BE-së për institucionet e pavarura; gjithashtu të luajë një rol proaktiv dhe në bashkëpunim me institucionet e tjera të bëjë propozimet për ndryshimet e nevojshme në Kodin e Ujit.*

Në zbatim të urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 581, datë 18.07.2018, ERRU ka marrë pjesë në grupin ndërinstucional të punës i ngritur për hartimin e një ligji të ri për sektorin ujësjellës kanalizime me propozimet dhe komentet e veta. ERRU ka dhënë komentet e saj në përgjithësi për draftin e ligjit të paraqitur nga Konsulenti në fund të Dhjetorit 2019, ndërsa në veçanti për rishikimin e ligjit 8102 për kuadrin rregullator ka propozuar ndryshimet e mëposhtme:

- Saktësimin e kompetencave të ERRU-së si institucioni që monitoron shoqëritë UK, dhe në përgjithësi sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura, shmangien e mbivendosjes së kompetencave me AKUM, si dhe përfshirjen në strukturën e saj të njësisë së benchmarkut që aktualisht ndodhet në AKUM.
- Anëtarët e komisionit të ERRU-së, përfshirë dhe kryetarin të zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë.
- Riformulimin e karakterit mjaft të përgjithshëm të kërkesave ndaj profilit të anëtarëve të komisionit duke i saktësuar ato në përputhje me kompetencat dhe fushën e aktivitetit të institucionit të ERRU-së në sektorin e ujit.
- Mandati i anëtarëve të komisionit të jetë 5 vjeçar në vend të atij aktual 4 vjeçar.
- Përmirësimi i disa elementeve jo thelbësorë të pavarësisë aktuale financiare të institucionit kryesisht për tepricat e buxhetit.
- Përmirësimi i disa aspekteve që lidhen me përmbushjen e disa kërkesave shtesë nga shoqëritë UK gjatë procesit të licencimit, dhe sidomos në atë të tarifave.
- Përmirësimi në drejtim të efektivitetit dhe zbatimit real në praktikë të neneve që lidhen me kundravajtjet e shoqërive UK për shkeljet e ndryshme ndaj detyrimeve të diktuar në licencën e lëshuar nga ERRU, si dhe të tarifave të aprovuara prej saj.

Theksohet edhe njëherë fakti që ERRU që në fillim ka mbështetur idenë se është i nevojshëm vetëm rishikimi i ligjit për kuadrin rregullator 8102, i Kodit të Ujit, si dhe rishikimi i disa akteve dhe akteve të tjera nënligjore që i përkasin formës së organizimit të shoqërive, akt-miratimit të lejes higjienore

sanitare, etj. Përfshirja e të gjithë problematikave të rregullimit të sektorit në një ligj të vetëm dhe në afate kohore të pamjaftueshme rrezikon cilësinë e këtij ligji, si dhe ndikimin e tij në funksion të përmirësimit të performancës së sektorit.

- ❖ *Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit të punojë për rishikimin dhe saktësimin e kriterëve të metodologjisë për përbalueshmërinë duke ju referuar edhe përvojës ndërkombëtare, si dhe të dhënave të disponueshme nga INSTAT duke i kushtuar vëmendje të veçantë mbrojtjes së konsumatorëve me të ardhura të ulëta (jo mesatare).*

ERRU mban lidhje të ngushta me INSTAT dhe ka marrë të dhënat për vitin paraardhës në lidhje me rezultatet dhe të dhënat e anketimeve për shpenzimet mujore mesatare familjare (jo të ardhurat sepse ato akoma paraqiten me mjaft pasaktësi). Këto të dhëna përdoren si kriter sipas decilave sidomos për shtresat e varfëra të decilës së I-rë (jo të shtresës në nevojë) për përbalueshmërinë për tarifatat që propozojnë shoqëritë UK.

- ❖ *Për eliminimin e problemeve të licencimit të shoqërive UK në lidhje me plotësimin e kushteve të Akt Miratimit të Lejes Higjieno Sanitare dhe të inspektimeve që lidhen me to, në bashkëpunim me Inspektoratin Sanitar Shtetëror të propozohen ndryshimet përkatëse ligjore nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*

ERRU është angazhuar në mënyrë mjaft aktive për realizimin e kësaj detyre dhe ka zhvilluar takime pune me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, MEI, si dhe me disa Drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik që përfshijnë shoqëritë të cilat kanë probleme me marrjen e akt miratimeve higjieno sanitare, ku është njohur më konkretisht me problematikat që kanë hasur shoqëritë.

Në përfundim të këtyre takimeve në korrik të vitit 2018 i është dërguar shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Mbi nevojën për ndryshime në legjislacionin që rregullon dhënien e Akt Miratimit Higjiena Sanitar" dhe ngritjen e një Grupi Pune për këtë qëllim. Rishikimi i akteve nënligjore për saktësimin e procedurave praktike të dhënies së Akt Miratimit Higjiena Sanitar duhet të bëhet në respektim të VKM nr. 379 në funksion të garantimit të cilësisë së ujit të pijshëm.

Aktualisht procesi po udhëhiqet nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale dhe po monitorohet nga Kryeministria duke filluar nga nënshkrimi i kontratave që shoqëritë UK duhet të nënshkruajnë me Drejtoritë Rajonale të Shëndetit për pikat e monitorimit të cilësisë së ujit në rrjetet shpërndarëse të ujësjellësave.

- ❖ *Të vijojë bashkëpunimin me institucione, veprimtaria e të cilave është e lidhur dhe ndikon në çështje që kanë të bëjnë me sektorin e Ujësjellës Kanalizimeve, në mënyrë të veçantë me Autoritetin e Konkurrencës.*

ERRU intensifikoi bashkëpunimin dhe marrëdhëniet dy palëshe me Autoritetin e Konkurrencës. Në datë 17.10.2018, dy institucionet nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi me qëllim

bashkëpunimin mes tyre për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive dhe garantimin e mbrojtjen e interesave publike dhe krijimin e një mjedisi transparent ligjor në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura. Memorandumi, në veçanti, përcakton afate të shqyrtimit të projekt akt-vendimeve të ERRU-së për tarifën, si dhe pjesëmarrjen e ERRU-së gjatë seancave të shqyrtimit të tyre nga Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës.

- ❖ *Në kuadër të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve për garantimin e shërbimeve cilësore nga shoqëritë UK, si dhe mbrojtjen e tyre ndaj abuzimeve për shërbimet monopol të ujësjellës kanalizimeve të ujërave të ndotura të punojë për hartimin e një rregulloreje për trajtimin e ankesave të konsumatorëve.*

Me qëllim përmirësimin e procesit të trajtimit të ankesave të konsumatorëve dhe nevojës për dhënie e rekomandimeve të pranueshme për të dyja palët si për konsumatorin dhe për shoqërinë UK, grupi i punës pranë Drejtorisë Juridike dhe Konsumatorit të ERRU-së ka vijuar punën gjatë vitit 2018 për hartimin e Rregullores për Trajtimin e Ankesave të Konsumatorëve. Drafti përfundimtar i kësaj rregullore ka kaluar për shqyrtim në Komisionin Kombëtar Rregullator dhe pritet të kalojë për miratim në gjashtëmuorin e parë të vitit 2019.

- ❖ *Në kuadër të rritjes së transparencës ndaj konsumatorëve të publikojë në faqen web të institucionit, si dhe të përdorë mediat sociale për më shumë informacion veçanërisht në lidhje me ndryshimin e tarifave, performancën e shoqërive UK dhe treguesve kryesorë të cilët përbëjnë interes të drejtpërdrejtë dhe të prekshëm për konsumatorët, si dhe të fillojë përpjekjet për gjetjen e rrugëve të instalimit të një sistemi digjital qendror ndër-institucional raportimi me të dhëna që raportohen "online" nga shoqëritë e UK, dhe këto të dhëna të jenë disponibël në web.*

ERRU ka publikuar në mënyrë sistematike në web të gjitha vendimet e marra për miratim të tarifave, të licencave si dhe të çdo vendimi tjetër rregullator të marrë nga KKRR gjatë vitit 2018. Gjithashtu, në fund të Qershorit 2018 në faqen e saj të web-it ERRU ka publikuar edhe Raportin e Performancës së Shoqërive UK, në të cilin jepet i gjithë informacioni dhe analiza e performancës së Sektorit në përgjithësi dhe e çdo shoqërie UK në veçanti. Në lidhje me sistemin dixhital të raportimit "online" nga shoqëritë UK ende nuk ka një përparim. Gjithsesi, kjo mbetet përsëri në kompetencën e Njësisë së Monitorim Benchmark-ut pranë AKUM.

- ❖ *Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, të rrisë përpjekjet dhe të luajë një rol proaktiv duke përdorur instrumentat ligjore që ka në dispozicion në mënyrë që brenda viti 2018 asnjë territor në Republikën e Shqipërisë mos të ketë të pa përcaktuar një tarifë zyrtare të furnizimit largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.*

ERRU ka ushtruar presion të vazhdueshëm me anë të vizitave në vend duke zhvilluar takime me Kryetarë të bashkive dhe Drejtues të shoqërive UK që në kuadër të reformës në sektor të përfundojnë sa më shpejt procesin e riorganizimit të tyre dhe të aplikojnë për tarifa për të gjithë zonën e shërbimit të shtuar kryesisht me atë të zonave rurale.

Gjatë vitit 2018 për shoqëritë e riorganizuara sipas reformës territoriale, ERRU ka aprovuar tarifa për tetë (8) shoqëri UK, përkatësisht: UK Berat-Kuçovë, UK Korçë, U Malësi e Madhe, U Gramsh, UK Skrapar, UK Maliq, UK Vau Dejës dhe UK Librazhd Prrenjas.

Në proces analize janë edhe nëntë (9) shoqëri, si UK Gjirokastrë, UK Polican, UK Delvinë, UK Lushnjë, UK Krujë, UK Vlorë, UK Vorë, UK Himarë dhe UK Roskovec.

Gjithashtu, në fund të vitit ka aplikuar për nivel të ri tarifor edhe shoqëria UK Tropojë si dhe janë në fazën e përgatitjes së dokumentacionit për ta paraqitur pranë ERRU-së pasi kanë zhvilluar seancat dëgjimore me publikun shoqëritë UK Belsh dhe UK Cërrik.

- ❖ *Të përdorë instrumentet ligjore në dispozicion dhe të marrë masa administrative për të gjithë ato ndërmarrje që nuk plotësojnë kushtet për të ushtruar veprimtarinë e tyre të furnizimit me ujë dhe për pasojë sjellin cenimin e drejtpërdrejtë të standardeve për konsumatorët.*

Plotësimi i standardeve të shërbimit për konsumatorët paraqitet akoma një detyrë mjaft e vështirë për t'u realizuar nga shoqëritë UK, sidomos aktualisht në fazën e riorganizimit të tyre. Gjithsesi, ERRU është duke luajtur një rol proaktiv që shoqëritë UK të përmirësojnë treguesit e performancës dhe të plotësojnë standardet për konsumatorët.

Gjatë vitit 2018, në kuadër të zbatimit të ligjit 8102, ERRU ndërmori 3 inspektime dhe vendosi masa administrative - gjobë për të tre shoqëritë UK të inspektuara. Vlen të theksohet se fillimi i procedurave për marrjen e masave administrative dha efektet e para me licencimin e dy prej shoqërive të cilat operonin pa licencë për shërbimin ujësjellës kanalizime.

- ❖ *Të rrisë përpjekjet për të garantuar një sistem transparent nga të gjitha shoqëritë UK për mënyrën sesi konsumatori mund të verifikojë detyrimet e tij përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe të mbështesë dhe inkurajojë implementimin e politikave lehtësuese për kryerjen e pagesave nga konsumatorët.*

ERRU gjatë analizës së shoqërive që kanë aplikuar për nivel të ri tarifor gjatë vitit 2018 është treguar e kujdesshme në drejtim të nxitjes së tyre për të operuar me sisteme faturimi elektronike, pasi ka akoma shoqëri që operojnë me faturim në mënyrë manuale. Nga ana tjetër, sistemi i faturimit elektronik paraqet vështirësi/pamundësi aplikimi sidomos për zonat rurale që i janë shtuar shoqërive të riorganizuara mbas reformës territoriale.

- ❖ *Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve të monitorojë nga afër shoqëritë UK që nga njëra anë të mos abuzojnë me vendosjen e ujëmatësve, cilësinë e tyre si dhe të respektojnë kushtet e kontratës me konsumatorin dhe nga ana tjetër të nxisë shoqëritë UK të instalojnë ujëmatësat individuale, si një proces që do të ndikonte në uljen e nivelit të faturimit aforfe për konsumatorët dhe të treguesit të Ujit Pa të Ardhura.*

Gjatë vitit 2018 pranë ERRU-së janë paraqitur 3 ankesa nga konsumatorët familjarë në lidhje me problematikat e ujëmatësve. Dy ankesat e para janë trajtuar nga ERRU, por nuk kanë gjetur zgjidhje të favorshme për konsumatorin. ERRU, në të dyja rastet ka dhënë rekomandimet e duhura për

zgjidhjen sa më të drejtë të tyre. Ankesa e tretë është zgjidhur në favor të konsumatorit dhe është dëmtshpërblyer për heqjen pa të drejtë të ujëmatësit.

ERRU në të gjitha kontaktet dhe vizitat në shoqëritë UK ka inkurajuar që ato të shohin me prioritet instalimin e ujëmatësive individualë për të gjithë konsumatorët. Pajisja me ujëmatës individual është domosdoshmëri për të respektuar të drejtën që çdo konsumator të paguajë saktësisht për sasinë e ujit të konsumuar, por përbën gjithashtu një instrument për mirëmenaxhimin e burimit të ujit dhe uljen e kostove nga shpërdorimet. Nga ana tjetër pajisja me ujëmatës individualë është një nga objektivat kryesorë që ERRU i vendos shoqërive kur ato aplikojnë për tarifa të reja.

- ❖ *Duke patur parasysh mbingarkimin me staf të shoqërive UK, gjatë procesit të miratimit të tarifave të kërkojë nga shoqëritë argumentim të plotë mbi numrin e punonjësve, pozicionet dhe përshkrimet e tyre të punës në strukturën organizative të shoqërisë.*

Ky problem ka filluar të trajtohet me vendosmëri dhe me detaje nga ERRU në lidhje me justifikimin e numrit të punonjësve dhe pozicionet e tyre në shoqëritë UK gjatë analizës për të gjitha shoqëritë të cilat kanë aplikuar për nivel të ri tarifor gjatë vitit 2018.

Mbetet problem gjithsesi ngarkesa artificiale me staf për shërbimet roje në veprat e sistemeve të furnizimit me ujë, si depo, stacione pompimi, për garantimin e sigurisë në këto vepra. ERRU propozon që në mjaft raste ky zë i kostove mund të zvogëlohet duke përdorur metoda të tjera alternative teknike dhe veçanërisht logjistike (instalimi i sistemeve të survejimit me kamera), por që kërkon ndryshime të akteve ligjore përkatëse.

- ❖ *Të hartojë dhe botojë Raportin e Performancës së Shoqërive Ujësjetës Kanalizime për vitin 2017 jo më vonë se mesi i Korrikut 2018.*

ERRU ka realizuar të printuar dhe publikuar në fund të Qershorit 2018 në faqen e saj të web-it Raportin Vjetor të Performancës së Sektorit UK.

- ❖ *Në koordinim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të vijojë nxitjen që shoqëritë UK të instalojnë ujëmatësive të mëdhenj në të gjithë pikat kyçe të sistemeve të furnizimit me ujë, si në prodhim, marrje nga transmisionet kryesore, depot dhe zonat e rrjetit shpërndarës për të bërë të mundur hartimin e bilanceve të sakta të ujit, si bazë e Planeve 5 Vjeçare të Biznesit të tyre.*

ERRU ka propozuar në mënyrë të vazhdueshme në MIE si dhe ka rekomanduar shoqëritë UK që të marrin masa për instalimin e ujëmatësive të mëdhenj të sistemeve të furnizimit me ujë. Për këtë MIE dhe AKUM gjatë vitit 2018 kanë hartuar edhe një plan pune ku është parashikuar pajisja e të gjitha shoqërive me ujëmatës të mëdhenj, por kjo detyrë ka mbetur akoma nën përgjegjësinë dhe planin e veprimit të AKUM-it.

- ❖ *Në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ERRU të jetë pjesë e vendimmarrjes në investimet që kryhen në sektorin e ujësjetës kanalizimeve nga sektori publik dhe ai privat nëpërmjet aprovimit sipas kritereve tekniko ekonomike të projekteve në sektor dhe të përcaktimit të prioriteteve të tyre.*

Kjo çështje është akoma në proces, pasi synohet të trajtohet në ndryshimet ligjore që do të bëhen në ligjin e ri për sektorin e ujit gjatë vitit 2019

- ❖ *Të luajë një rol nxitës dhe të ndërgjegjësoar që paralelisht me reformën të fillojë realizimi i një ose më shumë shembujve pilot agregimi të suksesshëm të shoqërive UK në sektor.*

ERRU e ka ngritur në mënyrë të vazhdueshme shqetësimin për nevojën që ka sektori UK për agregimin e shoqërive. Kjo është shprehur edhe në raportin vjetor dhe atë të performancës së shoqërive UK të vitit 2017, por akoma nuk ka filluar zbatimin për një projekt të tillë.

ERRU i ka adresuar opinionet e veta MIE dhe specialistëve të Kabinetit të Kryeministrit në lidhje me realizimin e një procesi agregimi të suksesshëm si më poshtë:

- Realisht në vendin tonë nuk ka ndonjë eksperiencë me të vërtetë të suksesshme agregimi që duhet marrë si shembull, prandaj është e nevojshme që të gjendet mundësia e gjetjes dhe zbatimit të disa rasteve (2, 3 ose më shumë) që të shërbejnë si eksperiencë pozitive për agregimin e mëtejshëm të sektorit me të gjitha elementet që nënkupton agregimi.
- Nisjen e procesit të agregimit si avantazh i ekonomisë së shkalles sipas principit “në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore”.
- Për këtë rekomandohet që të realizohet një studim (survey) i shpejtë me bazë anketimi (komunikimi) direkt me kryetarët e të gjithë bashkive në të gjithë vendin për të vlerësuar disa raste favorite agregimi (2, 3 ose më shumë) të cilat në baza vullnetare dhe në bashkëpunim me qeverinë qendrore (incentiva) të arrihet marrëveshja e agregimit ndërmjet tyre.
- ERRU do të ndihmojë edhe në procesin e përcaktimit të tarifave orientuese që duhet të përdoren si argument gjatë diskutimit me kryetarët e bashkive.

3 Niveli i Zbatueshmërisë së Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura nga Ekzekutivi

Një pjesë shume të rëndësishme në raportin vjetor të aktivitetit të ERRU-së zë edhe pjesa e Rekomandimeve të nevojshme për t'u ndërmarrë nga qeveria qendrore për përmirësimin e performancës së sektorit të ujit. Në raportin vjetor të aktivitetit të ERRU-së për vitin e mëparshëm, 2017, të dërguar pranë Këshillit të Ministrave si dhe të prezantuar në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë nga Kryetari i këtij institucioni janë dhënë disa rekomandime të cilat kërkojnë domosdoshmërisht ndërhyrjen dhe mbështetjen e qeverisë qendrore.

Rekomandimet e dhëna nga ERRU në vitin e mëparshëm konsistojnë kryesisht në disa pika konkrete të nevojshme për t'u ndërmarrë në konsideratë nga qeveria qendrore për përmirësimin e sektori UK në vendin tonë dhe kanë të bëjnë me:

- ERRU të jetë pala monitoruese, përcaktuese dhe vlerësuese e treguesve të performancës së kontratave që do të lidhen në kuadër të reformës për ujin ndërmjet AKUM dhe bashkive;
- Saktësimi dhe ndarja e përgjegjësisë dhe të drejtave midis ERRU-së dhe AKUM që aktualisht janë konfuzë dhe me mbivendosje;

- Për të luajtur plotësisht rolin si monitorues i shoqërive UK dhe të sektorit të ujit duke përfshirë në strukturën e tij Njësinë e Monitorim Benchmark që aktualisht ndodhet pranë AKUM;
- Ngritjen institucionalisht të Këshillit Teknik pranë AKUM për vlerësimin tekniko ekonomik të të gjitha projekteve të propozuara në fushën e ujësjellës kanalizimeve me përfaqësues edhe nga ERRU;
- Propozim për rishikimin e VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", me rekomandime konkrete në funksion të kërkesave të situatës aktuale të reformës së sektorit;
- Për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarit të KKRR jo nga Këshilli i Ministrave, por nga Kuvendi i Shqipërisë, si dhe të kohëzgjatjes së mandatit nga 4 në 5-vjeçar, përfshirë dhe kriteret që ato duhet të përmbushin;

Konstatohet se në mbyllje të vitit 2018 rekomandimet e dhëna nga ERRU në vitin e mëparshëm janë akoma në një fazë diskutimesh dhe nuk kanë hyrë në zgjidhje konkrete, me gjithë përpjekjet nga ana e saj të bëra prezent në mënyrë të vazhdueshme edhe gjatë takimeve që ERRU ka zhvilluar me Ministrinë e linjës (MIE), Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) dhe aktorët e tjerë që veprojnë në sektorin UK.

ERRU me pjesëmarrjen në grupin e punës për hartimin e një ligji të ri për sektorin UK synon të ndikojë në qartësimin e kompetencave ndërmjet institucioneve si dhe në rritjen e rolit të ERRU-së në monitorimin e sektorit UK. Gjithashtu synohet edhe forcimi i pavarësisë institucionale të këtij institucioni.

4 Gjendja në Sektorin e Ujësjellës Kanalizime

4.1 Gjendja e Performancës së Sektorit UK për Vitin 2018

ERRU monitoron dhe analizon në mënyrë të vazhdueshme gjendjen dhe performancën e secilit operator dhe të sektorit në tërësi për shërbimet e furnizimit me ujë, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

Analiza e plotë e sektorit të ujit në përgjithësi dhe e çdo shoqërie në veçanti jepet në Raportin Vjetor të Performancës që hartohet dhe botohet nga ERRU në fund të Qershorit të vitit pasardhës pasi disponohen të dhëna të plota vjetore të shoqërive UK.

Monitorimi dhe analiza bëhet mbi bazën e Treguesve Kryesorë të Performancës, të miratuar nga KKRR. Tabela 5 jep nivelet e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2018 dhe tendencën e tyre krahasuar me vitin paraardhës.

Tabela 5. Treguesit Kryesorë të Performancës

Treguesit e Performancës	Njësia e Matjes	Viti 2017	Viti 2018	Tendenca
Mbulimi me Furnizimin me Ujë	%	78.3	78.2	=
Mbulimi me Kanalizime	%	50.2	51.6	↗
Mbulimi i Kostove O&M	%	109	124	↗
Norma e Arkëtimit Korente	%	78.84	79	=
Niveli i Matjes	%	68.3	73.3	↗
Ujë pa të Ardhura	%	65	63.4	↗
Efiçenca e stafit	(stafi/1000lidhje UK)	5.5	5.32	↗
Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	12	11.65	↘

Llogaritja e treguesve të performancës për vitin 2018 është bërë bazuar në të dhënat e 9 muorit të vitit 2018, të vëna në dispozicion nga AKUM dhe të ekstrapoluara për kohëzgjatjen vjetore të tyre. Siç shihet nga tabela e treguesve kryesorë të performancës, konstatohet se shumica e treguesve kanë tendencë pozitive që tregojnë për një përmirësim të situatës teknike ekonomike të sektorit.

Sektori UK është pothuajse i riorganizuar sipas Reformës Territoriale, përse i përket zonave të shërbimit dhe raportimit të të dhënave, por aktualisht janë rreth 40% e shoqërive të pa licencuara nga ERRU për shkak të problematikave ligjore në drejtim të vlerësimit, transferimit të asetëve dhe regjistrimit të tyre në QKB, apo mos marrjes së Akt Miratimit Higjieno Sanitar nga Instituti Shtetëror Shëndetësor.

Në përgjithësi, treguesit kryesorë të performancës kanë ndërvarësi nga njëri-tjetri dhe ndikimi pozitiv apo negativ i secilit tregues reflektohet dhe në treguesit e tjerë.

Më poshtë jepet në mënyrë të detajuar performanca e secilit tregues të performancës dhe interpretimi i shkaqeve të përmirësimit/përkeqësimit të tyre në krahasim me vitin paraardhës.

"Mbulimi me Furnizimin me Ujë" për vitin 2018 është pothuajse në të njëjtin nivel me vitin paraardhës me një ndryshim minimal me (-0.09%). Popullsia në Juridiksion ka pësuar një rritje me rreth 292.579 banorë dhe nga ana tjetër dhe popullsia e shërbyer është rritur me rreth 226.910 banorë. Në zonën urbane shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm ofrohet për 93.36% të popullsisë kundrejt 57.83 % që ofrohet në zonën rurale.

Ky përkeqësim i lehtë i këtij treguesi vjen si shkak i përfshirjes në zonën e shërbimit të shoqërive UK të riorganizuara të mjaft zonave rurale (zona të bardha) në të cilat nuk ekzistojnë sisteme inxhinierike të furnizimit me ujë.

"Mbulimi me Kanalizime" ka shënuar një përmirësim me 1.4% duke shënuar nivelin 51.6% kundrejt 50.2% që ishte në vitin 2017. Ky tregues i përmirësuar llogaritet duke u bazuar në të dhënat që rritja e popullsisë në juridiksion është shoqëruar me rritje të popullsisë së shërbyer me kanalizime që raportohet me 2.130.700 banorë kundrejt 1.910.000 që ishte në vitin 2017.

Duke patur parasysh që popullsia në zonën e shërbimit që përfshin të gjithë territorin administrativ të bashkive është rritur, ky tregues duhet të ishte përkeqësuar akoma më shumë sesa ai i mbulimit me shërbime të furnizimit me ujë, sepse është evident fakti që përgjithësisht mungojnë rrjetet e kanalizimeve të ujarëve të ndotura në zonat rurale. *Pra përfundimisht ky tregues nuk rezulton i besueshëm dhe kërkon verifikime të mëtejshme të të dhënave të tij.*

Nga ana tjetër, përmirësimi në të ardhmen i këtij treguesi (shërbimi) kërkon domosdoshmërisht ndërhyrjen me investime, që realisht vëmendja kryesore ka qenë e fokusuar kryesisht në drejtim të furnizimit me ujë të pijshëm pasi edhe efekti në popullatë është më i ndjeshëm tek ky shërbim.

"Mbulimi i Kostos së Operimit dhe Mirëmbajtjes" është treguesi që shpreh kostot e drejtpërdrejta si ato për personelin, energjinë, kimikatet dhe kosto të tjera që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen dhe shkallën e mbulimit të tyre me të ardhurat e realizuara nga veprimtaria kryesore. Për vitin 2018, mbulimi i kostove O&M me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti në sektor është 124% nga 109% që ishte në vitin 2017.

Ky tregues ka pësuar një përmirësim të ndjeshëm me 15% krahasuar me vitin paraardhës pasi të ardhurat nga aktiviteti UK janë rritur ndjeshëm me rreth 18% ndërkohë që kostot O&M janë rritur vetëm me rreth 3% krahasuar me periudhën paraardhëse.

Kjo situatë e sektorit paraqitet qartë në Tabelën 6 ku jepet ecuria e kostove sipas zërave sintetik të tyre për vitet 2017 dhe 2018 si dhe të ardhurat nga aktiviteti për të njëjtën periudhë.

Tabela 6. Ecuria e Kostove dhe të Ardhurave krahasuar me vitin paraardhës

Nr.	Emërtimi	Viti 2017	Viti 2018	Diferenca
	<i>Kostot e Shërbimit UK</i>	<i>në 000 lekë</i>	<i>në 000 lekë</i>	<i>në 000 lekë</i>
1	Kosto e punës	3,367,455	3,710,451	+342,996
2	Kosto e kimikateve	162,998	204,700	+41,702
3	Kosto e energjisë së konsumuar	2,516,869	2,322,057	-194,812
4	Kosto e karburanteve	2,405	2,843	+438
5	Kosto e riparim/mirëmbajtjes	705,816	494,670	-211,146
6	Kosto e shërbimeve të kontraktuara	638,394	778,957	+140,563
7	Kosto e blerjes së ujit	90,385	113,402	+23,017
8	Kosto të tjera operacionale	244,610	371,141	+126,531
	Kostot Operim & Mirëmbajtjes	7,728,932	7,998,221	+269,289
	Të Ardhurat nga Aktiviteti			
1	Të ardhurat nga faturimi UK	7,472,654	9,294,948	+1,822,294
2	Të ardhura të tjera të aktivitetit	920,765	627,268	-293,497
	Të Ardhurat Totale	8,393,419	9,922,216	+1,528,797
	Niveli i Mbulimit të Kostove			
	Mbulimi i Kostove të O & M	109%	124%	+15%

Ndër zërat me rritje të kostove përmenden kostot e punës të cilat kanë pësuar një rritje të konsiderueshme me 343 milion lekë për shkak të shtimit të stafit gjatë vitit 2018 me 333 punonjës, si

dhe ato të shërbimeve të kontraktuara janë rritur me rreth 140 milion lekë që justifikohen ngaqë shumë shoqëri kanë lidhur kontrata shërbimi me njësi të licencuara për kryerjen e shërbimit të rojeve.

Nga ana tjetër, zërat e kostove të energjisë së konsumuar dhe ato të riparimit dhe mirëmbajtjes që kanë ulje të konsiderueshme e cila pretendohet se vjen si rezultat i përmirësimit të menaxhimit sepse konstatohet që sasia e ujit të prodhuar për vitin 2019 raportohet pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2017. Gjithashtu dhe investimet e kryera në shumë shoqëri kanë sjellë uljen e nevojës për riparime të rrjeteve, që do të thotë pakësim të kostove të riparimit dhe mirëmbajtjes.

ERRU vazhdimisht e ka konsideruar analizën financiare të shoqërive si një domosdoshmëri edhe gjatë monitorimit të shoqërive. Rëndësi të veçante i kushtohet sidomos në fazën e aplikimit të shoqërive për ndryshimin e nivelit të tarifave me qëllim marrjen në konsideratë të kostove të domosdoshme për tu përballuar nga tarifat e shërbimeve UK për të evituar ndonjë mbivlerësim të tyre.

Të ardhurat nga aktiviteti UK janë rritur ndjeshëm, konstatohet që kjo rritje në rreth 80% ka ardhur nga efekti pozitiv i ndryshimit të tarifave si dhe rritjes së numrit të lidhjeve të cilët paguajnë edhe tarifë fikse. Pjesa tjetër prej rreth 20% vjen nga përmirësimi i nivelit të faturimit për shërbimin e ujit të pijshëm dhe i kanalizimeve të ujërave e të ndotura.

Gjithsesi edhe pse si sektor ky tregues për vitin 2018 krahasuar me vitin para ardhës ka pësuar një përmirësim të ndjeshëm, vetëm 17 shoqëri arrijnë të mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes mbi 100%, të cilat përfaqësojnë rreth 60% të popullsisë së shërbyer. Nga ana tjetër, janë 20 shoqëri që mbulojnë kostot O&M deri në nivelin 70% ku nevoja për subvencione është e domosdoshme dhe pjesa tjetër e shoqërive janë në nivelet 71% deri 99% të këtij treguesi. Kjo tregon se sektori vazhdon të jetë në gjendje të rënduar financiare që kërkon forcimin e masave për shëndoshjen financiare të tij.

Në raportimet e shoqërive për periudhën janar-shtator 2018, janë rreth 43.8 milion lekë subvencione të dhëna nga Bashkitë për përballimin e kostove apo për ndonjë investim të mundshëm. Nuk disponohet informacion lidhur me subvencionet e qeverisë për performancë të mirë apo mbulimin e diferencës kosto-çmim.

"Norma e Arkëtimit Korente" është një tregues, i cili përcakton nivelin e arkëtimit të shitjeve të vitit 2018 për shërbimet UK. Ky tregues është rillogaritur nga ERRU pasi informacioni i marrë nga AKUM ka pasaktësi në lidhje me raportimet e shoqërive UK për shumën e arkëtimit korente dhe atyre të prapambetura (debive).

Niveli i këtij treguesi për të tretin vit radhazi mbetet në të njëjtin nivel rreth 79%. Gjithsesi, brenda 57 shoqërive ka nga ato shoqëri që kanë performancë shumë të mirë, me nivele mbi mesataren e sektorit si, UK Tiranë, UK Berat-Kuçovë, UK Maliq, UK Peqin, UK Librazhd etj, por nga ana tjetër ka shumë shoqëri me nivele të ulëta arkëtimit nën 60% si, UK Kukës, UK Peshkopi, UK Gramsh, UK Pustec, UK Roskovec, UK Sarandë etj.

Mbajtja e këtij treguesi në nivel të njëjtë këto dy vitet e fundit mund të konsiderohet si tregues i përmirësuar duke patur parasysh përfshirjen e zonave rurale nën administrimin e shoqërive UK, të cilat në përgjithësi këtë tregues e kanë mjaft nën mesataren në rang vendi.

Pavarësisht nga sa më sipër shoqëritë UK duhet të rrisin akoma përpjekjet e tyre për përmirësimin e këtij treguesi si një nga drejtimet kryesore për të rritur qëndrueshmërinë financiare të shoqërive. ERRU ka në vëmendjen e saj kryesore vendosjen e objektivave agresive për shoqëritë UK gjatë procesit të analizës dhe aprovimit të tarifave të reja të propozuara prej tyre për të minimizuar rritjen artificiale të tarifave në kurriz të një norme arkëtimi jo në nivelet e kërkuara.

"Uji Pa të Ardhura", si treguesi më i rëndësishëm i performancës, për vitin 2018 ka një përmirësim me 2% krahasuar me vitin paraardhës, por ende mbetet në nivele të larta. Zgjerimi i zonës së shërbimit, shoqëruar me rreth 60.000 lidhje të reja uji ka sjellë rritje të sasisë së ujit të faturuar me 6.2 milion m³/në vit. Nga ana, tjetër edhe sasia e ujit të prodhuar dhe që hyn në sistem është ulur me rreth 1.9 milion m³/në vit.

Performanca pozitive e këtij treguesi duhet marrë me rezervë, sepse llogaritja e tij bëhet në baza vlerësimi (jo matje) për shkak të mungesës në përgjithësi të matësave të ujit në burim. Fatmirësisht, pajisja me matësa në burim shihet si përparësi në masat e reformës, çështje të cilën ERRU gjithashtu ia adreson shoqërive UK gjithnjë në rekomandimet e saj gjatë analizës dhe aprovimit të tarifave të reja të propozuara prej tyre.

Për vitin 2018 mesatarisht prodhohet 304 litra ujë në ditë për frymë dhe faturohet 107 litra ose prodhimi mujor mesatar për një lidhje familjare është 35 m³ në muaj dhe faturimi është 12 m³ në muaj/lidhje.

Reduktimi i humbjeve mbetet prioritet i shoqërive dhe përbën sfide mjaft të madhe për shoqëritë UK. Në këtë kuadër vëmendje e veçantë po i kushtohet zbatimit të planeve të veprimit për përmirësimin e këtij treguesi (uljen e humbjeve) për tetë shoqëritë UK kryesore në vend, studim i realizuar gjatë vitit 2018 me konsulencë të huaj dhe financuar nga GIZ.

Ndër elementet kryesore të planeve të veprimit, në kuadër të reformës, në këtë drejtim është legalizimi i lidhjeve të paligjshme, pajisja 100% e konsumatorëve me matësa individuale, forcimi i masave administrative e penale ndaj kundërvajtësve si dhe instalimi i matësve në burim e në depo me qëllim matjen e sasisë së ujit të prodhuar.

ERRU e konsideron këtë tregues shumë të rëndësishëm dhe ka forcuar kërkesat ndaj shoqërive UK për të paraqitur një bilanc real të ujit në sistemet e tyre të furnizimit me ujë, si një element bazë edhe i planit të biznesit 5-vjeçar që shoqëritë duhet të hartojnë me plane përkatëse të veprimit për të realizuar zvogëlimin e "Ujit Pa të Ardhura".

"Niveli i Matjes" është përmirësuar me 5%, krahasuar me vitin 2017. Në mbyllje të vitit 2018 rezultojnë rreth 629 357 lidhje me matës nga 544 867 që ishin në vitin 2017, pra me një rritje prej 84 490 lidhje që kanë ardhur kryesisht nga lidhjet e reja si rezultat i riorganizimit, por dhe nga investimet e bëra në sektor. Ende raportohen rreth 10 300 klientë jo familjarë pa matës në kundërshtim me VKM nr. 96, datë 21.02.2007.

Siç u theksua më sipër, sektori, fatmirësisht e ka prioritet të investimeve instalimin e matësve për të gjithë konsumatorët.

"Eficienca e Stafit" ka një përmirësim minimal me 0.18% krahasuar me vitin 2017. Edhe pse numri i lidhjeve të ujit është rritur me rreth 60 800 lidhje dhe ai i kanalizimeve me rreth 54 500 lidhje, efekti pozitiv që duhet të jepte ky përmirësim është minimizuar për faktin se gjatë vitit 2018 në total stafi i shoqërive UK është rritur me 333 punonjës.

Nevoja e zgjerimit të shërbimit i ka detyruar shumë shoqëri që të shtojnë personelin me qëllim përmirësimin e shërbimit deri te konsumatori. Ky tregues është gjithashtu në nivele jo të mira edhe për shkak të shtimit artificial të stafit për shërbimet roje, të cilat mund të rregullohen në mënyrë teknike dhe logjistike. Shoqëritë UK duhet të marrin në konsideratë si prioritet kryesor reduktimin e stafit të tepërt, si një nga zërat kryesorë të kostos së shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve.

Është i njohur fakti që ka mjaft staf të tepërt në shoqëri UK, të pajustificuar. ERRU e sheh si një prioritet të punës së saj në të ardhmen analizën e thelluar të organigramës dhe numrit të stafit që operon shoqëria. Shoqëritë duhet të justifikojnë secilin pozicion të stafit të saj dhe me përshkrimin përkatës të punës. Veçanërisht, kjo analizë do të zhvillohet kur shoqëria aplikon për tarifa të reja shoqëruar me një plan biznesi 5 vjeçar. ERRU do të marrë iniciativën gjithashtu që të korrigjohet legjislacioni për sigurinë në objekte për zëvendësimin e shërbimeve roje me zgjidhje teknike dhe logjistike përkatëse.

"Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë" është përkeqësuar me 0.35 orë më pak furnizim me ujë të pijshëm në 24 orë. Tendenca negative e këtij treguesi shpjegohet me faktin se shumë shoqëri janë riorganizuar gjatë vitit 2018 duke marrë zona rurale të shërbyera pjesërisht me orare të reduktuara apo zona të pa shërbyera nga asnjë shoqëri UK. Ky tregues shpreh në mesatare të përgjithshme kohëzgjatjen e furnizimit me ujë, pasi aktualisht janë 23 shoqëri që ofrojnë shërbimin me orare të zgjata mbi 13 orë /ditë dhe në zona të veçanta të shërbimit edhe 24/7 ditët e javës.

Gjithsesi, raportimi i këtij treguesi duhet marrë me rezervë, sepse në mjaft raste ai vlerësohet apriori dhe jo në vlerësime të hollësishme sipas zonave shpërndarëse të shërbimit.

Nivelet e arritura të treguesve janë të lidhura ngushtësisht me ndryshimet e ndodhura në sektorin UK. Situata aktuale nuk na lejon për një gjykim me realizëm të plotë të performancës së sektorit, pasi shoqëritë UK janë duke kryer procedurat e riorganizimit, gjë e cila ka ndikuar edhe në raportimin e të dhënave e për rrjedhojë edhe në përlogaritjen e treguesve.

Pozitiv është fakti që pavarësisht rezervave në saktësinë e të dhënave, konstatohet një tendencë përmirësimi të treguesve të operim mirëmbajtjes dhe atyre ekonomike. Gjithsesi një vlerësim përfundimtar mbi performancën e sektorit do të jepet nga ERRU në raportin vjetor për performancën e vitit 2018 ku është mundësia e një vlerësimi më të detajuar dhe të përjashtimit të ndonjë të dhëne evidente të pabesueshme.

4.2 Situata në Zbatim të Reformës në Sektorin e Ujit

Reforma në sektorin e ujit e cila i ka fillimet e saj në janar 2016, kohë kur u miratua VKM nr. 63. Ky akt parashikon riorganizimin e shoqërive UK sipas parimit 1 shoqëri = 1 bashki deri në fund të vitit 2016, proces i cili akoma nuk ka përfunduar për të gjitha shoqëritë UK.

Aktualisht shoqëritë UK operojnë dhe ofrojnë shërbimin sipas ndarjes së re territoriale, por nuk kanë arritur të plotësojnë kërkesat sipas parashikimeve që kishte procesi i riorganizimit në drejtim të inventarit fizik, vlerësimit dhe regjistrimit në pronësi të bashkisë të njësive të shërbimit në strukturën e aseteve dhe kontabilitetin e shoqërive UK. Prosesi parashikonte që brenda 3 muajve nga përfundimi i tij shoqëritë duhet të aplikojnë pranë Entit Rregullator të Ujit për licencim dhe miratimin e tarifave të reja për të gjithë zonën e re të shërbimit.

Rezultoi se riorganizimi i sektorit ishte një sfidë mjaft e madhe për shoqëritë dhe bashkitë për t'u realizuar në formën e kërkuar brenda afateve të përcaktuara në VKM. Prosesi i inventarizimit, vlerësimit dhe regjistrimit të aseteve dhe me pas regjistrimi i tyre në QKB paraqitej mjaft problematik, për shkak të mungesës së dokumentacionit përkatës nga ish komunat.

Përfundimisht, deri në fund të viti 2018 janë licencuar nga ERRU 30 shoqëri UK nga 57 që është totali i tyre, të cilat jepen në Tabelën Aneks 6, ndërkohë që nga fillimi i reformës deri në fund të vitit 2018 vetëm 15 shoqëri ujësjellës kanalizime kanë aplikuar për miratimin e tarifave edhe për zonën e re të shërbimit.

ERRU, në kuadër të reformës dhe qartësisht të përgjegjësisë ndaj saj, ka zhvilluar mjaft takime me kryetarët e bashkive dhe administratorët e shoqërive në të gjithë vendin për të nxitur zbatimin sa më të shpejtë e të drejtë të reformës në sektorin e ujit, duke ofruar edhe asistencë në lidhje me mënyrat dhe procedurat që duhen ndjekur për një realizim me sukses të procesit të inventarizimit të aseteve.

Në vijim të reformës në sektorin e ujit të lançuar nga qeveria qendrore që në Tetor të vitit 2017, me synim shëndoshjen financiare të shoqërive UK, krahas fushatës për eliminimin e lidhjeve të paligjshme në janar 2018 u procedua me nënshkrimin e kontratave të performancës ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) përfaqësuar nga AKUM dhe Bashkive në vend bazuar në tregues performance apriori dhe në vlera të njëjta për të gjitha shoqëritë, të cilat do të saktësoheshin nga analiza e realizimit të tyre në fund të vitit. Përcaktimi i vlerës së tyre nga vlerësimi i realizimit të tyre në fund të vitit do të shërbente si bazë nisje për vendosjen e objektivave për t'u arritur nga shoqëria në vitin në vazhdim (2019).

Për vitin 2018, si rezultat i reformës të iniciuar nga qeveria qendrore, sektori pati një ecuri pozitive në drejtim të :

- eliminimit të lidhjeve të paligjshme, si rezultat i aksionit të ndërmarrë në nivel kombëtar u arrit të evidentohet një numër i konsiderueshëm lidhjesh ilegale, kjo ndikoi edhe në rritjen e numrit të klientëve;
- rritjes së numrit të ujëmatësave të vendosur: pothuajse të gjitha shoqëritë për vitin 2018 kanë shtuar numrin e ujëmatësave të instaluar, kjo ka ndikuar edhe në përmirësimin e treguesit niveli i matjes;
- arkëtimeve të debive të prapambetura: u rrit ndjeshëm përgjegjshmëria qytetare për likuidimin e debive të prapambetura duke u bërë pjesë e marrëveshjeve individuale për shlyerjen e tyre.

Gjithsesi, në fund të vitit 2018 megjithë përmirësimin e lehtë të gjendjes financiare të sektorit, rezultoi se nuk u arritën pritshmëritë e parashikuar nga reforma sidomos në drejtim të influencës së uljes së humbjeve nga eliminimi i lidhjeve të paligjshme. Për uljen e humbjeve dhe hartimin e një plani veprimi për zvogëlimin e tyre me asistencën e huaj, financiar nga GIZ, u realizua një studim për tetë shoqëritë UK më të mëdha të vendit që ofrojnë shërbime për mbi 70% të popullsisë së vendit.

Në fund të vitit 2019, për përsheptimin dhe arritjen e përmirësimit të gjendjes në sektor, MEI përpiloi një qasje që akoma është në diskutim me të gjithë aktorët në sektor para se të formalizohet për zbatim. ERRU ka komentet e saj në drejtim të mundësisë të realizimit të saj në praktikë që i ka diskutuar në mbledhjet përkatës me aktorët për këtë qellim.

Qasja e propozuar për shëndoshjen e sektorit të ujësjellës kanalizimeve bazohet në ndarjen në dy kategori të shoqërive UK, përkatësisht në ato që operojnë duke mbuluar kostot e O&M dhe në ato të cilat kanë nevojë për subvencionim nga Qeveria Qendrore.

Propozimi merr në konsideratë shoqëritë e kategorisë që kanë nevojë për subvencion nga qeveria qendrore dhe propozon një Plan Veprimi për to me një shtrirje kohore zbatimi rreth dy vjeçare. Theksohet fakti se janë 42 nga 58 shoqëri UK që nuk arrijnë të mbulojnë kostot e O&M. Për këtë kategori të shoqërive, në princip, qasja propozon agregimin e tyre “të detyruar” në një shoqëri të vetme që do të menaxhohet nga një staf qendror (Struktura e Kompetencave të Përbashkëta ose SKP). Krijimi i një shoqërie të tillë gjigande nuk rekomandohet të krijohet, sepse eksperiencia ndërkombëtare dhe ajo e vendeve me kushte të përafërta me tonat nuk njejnë ndonjë shembull suksesi ku sektori (shitja e ujit me pakicë) është agreguar pothuajse në mënyrë të menjëhershme.

Shëndoshja afatshkurtër financiare e sektorit dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit pritet të vijë kryesisht nga reduktimi i fuqisë punëtore dhe rritja e normës së arkëtimit. Lënia në njëfarë mënyre, e bashkive jashtë procesit kompromenton sidomos faktorin e dytë (normën e arkëtimit), ku roli i bashkisë është mjaft i rëndësishëm në mbështetje kundër debitorëve dhe abuzuesve.

Studimi i bëshmerisë i vitit 2008 për agregimin e sektorit të ujit në Shqipëri, financiar nga Banka Botërore, ka konkluduar se agregimi duhet realizuar mbi baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore. Procesi duhet të jetë diskret (kërkon kohën e duhur), gradual, mbështetje me fonde (incentiva) dhe me angazhim të fortë institucional të pushtetit qendror dhe atij vendor.

Nga ana tjetër, krijimi i shoqërisë së agreguar në përmasa të tilla, në kufi kohorë mjaft të shkurtër, është pothuajse i pamundur të realizohet. Afati minimal për plotësimin e kërkesave burokratike të krijimit dhe vënies në operim të shoqërisë së agreguar është rreth 2 vjet.

Për sa më sipër, ERRU për vazhdimësinë e reformës në sektorin e ujit ka rekomanduar:

- Të vazhdohet procesi i vlerësimit të treguesve të performancës (të arritjes së objektivave) për secilën shoqëri UK, si proces mjaft i rëndësishëm në përcaktimin e instrumentave përkatës për shëndoshjen financiare të tyre;
- Në kontratat e reja të performancës ERRU & AKUM duhet të vlerësojnë sesa janë treguesit e performancës, të dakortësojë me shoqëritë objektivat që duhen arritur prej saj në fund të vitit 2019. Përfshirja e ERRU-së në këtë proces është domosdoshmëri për të vlerësuar se cilat nga shoqëritë UK kanë mundësi përmirësimi nga menaxhimi që të jenë financiarisht të pavarura, dhe cilat për arsye objektive (p.sh. kërkohen tarifa të papërballueshme) do të mbesin akoma subjekt i subvencionimit nga qeveria qendrore;

- Paralelisht me procesin e mësipërm duhet të punohet për nisjen e procesit të agregimit si avantazh i ekonomisë së shkallës sipas principit “në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore” duke synuar që fillimisht të realizohen 2-3 agregime të suksesshme.

5 Objektivat dhe Planet e Veprimit të Punës së ERRU-së dhe Sektorit të Ujit për Vitin 2019

- ❖ Në zbatim të urdhrin të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 581, datë 18.07.2018, ERRU do të kontribuojë në Grupin e Punës për hartimin e një ligji të ri për sektorin UK me propozime dhe komente, në veçanti për rishikimin e Ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit UK", i ndryshuar.
- ❖ Përfundimin e punës për rishikimin dhe hartimin e "Metodologjisë së vendosjes së tarifave për shërbimin e UK", në përputhje me kërkesat për një menaxhim bashkëkohor të sektorit dhe përfshirjen e eksperiencave më të mira të rregullatorëve Europiane në të. Metodologjia e përmirësuar do të ketë si bazë vlerësimi performancën tekniko-ekonomike të shoqërive dhe objektivat për përmirësimin e tyre në përputhje me planin e biznesit 5-vjeçar të shoqërisë, si dhe plotësimin të nevojave për investime.
- ❖ Të luajë një rol nxitës dhe ndërgjegjësues që në vazhdimësi të reformës të fillojë realizimi i 2-3 shembujve pilot agregimi të suksesshëm të shumë shoqërive UK në sektor. Një sektor mjaft i fragmentarizuar si i yni me rreth 60 shoqëri UK vuan nga mungesa e ekonomisë së shkallës dhe operon me kosto mjaft të larta. Së shpejti pritet që vendi ynë të hapë negociatat për pranimin në Bashkimin Europian, ku priten alokimi i fondeve të konsiderueshme nga BE për sektorin UK në përmbushje të standardeve të direktivës së ujit të KE. Agregimi duhet të mbështetet me incentiva (financime) nga qeveria qendrore.
- ❖ Miratimi i rregullores së trajtimit të ankesave të konsumatorëve brenda vitit 2019. ERRU ka rolin e ndërmjetësuesit dhe rekomanduesit në trajtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis ankesave të konsumatorëve dhe shoqërive UK Prandaj kjo rregullore shihet si një instrument i nevojshëm në mbështetje të procedurave sipas akteve në fuqi për një zgjidhje sa më të drejtë dhe efikase të ankesave të konsumatorëve.
- ❖ ERRU të planifikojë rishikimin dhe aprovimin e Kodit të Ujit, si akt nënligjor që duhet të jetë në kompetencë të saj (jo të Këshillit të Ministrave).
- ❖ Të rrisë kapacitetet profesionale të stafit me një planifikim të drejtë të trajnimit të tyre me burime të brendshme dhe të jashtme duke shfrytëzuar edhe mundësitë nga bashkëpunimet e gjëra dhe bilaterale me rregullatorët Europiane të sektorit të ujit.
- ❖ Të rrisë përpjekjet për të patur një bazë të dhënash të sakta duke rritur kërkesat ndaj shoqërive UK që është pjesë e propozimit të kalimit të Njesisë së Monitorimit të Benchmark-ut nga AKUM tek ERRU.
- ❖ Të marrë pjesë aktive në të gjithë Grupet e Punës dhe të aktiviteteve me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar ku trajtohen dhe diskutohen çështje thelbësore strategjike dhe tematika të veçanta të sektorit UK dhe në veçanti të kuadrin rregullator.

6 Rekomandime për Përmirësimin e Performancës së ERRU-së dhe për Sektorin e Ujit

Për vazhdimësinë e një reforme të suksesshme në sektorin UK, dhe të përmirësimit të performancës së ERRU-së rekomandohet:

- Në vend të qasjes së propozuar të vazhdohet procesi i vlerësimit të treguesve të performancës (të arritjes së objektivave) për secilën shoqëri UK, si proces mjaft i rëndësishëm në përcaktimin e instrumentave përkatës për shëndoshjen financiare.
- Në kontratat e reja të performancës përveç AKUM të përfshihet edhe ERRU në procesin e vlerësimit të treguesve të performancës, dhe në përcaktimin e objektivave për shoqëritë në të ardhmen.
- Paralelisht me procesin e mësipërm duhet të punohet për nisjen e procesit të agregimit si avantazh i ekonomisë së shkallës sipas principit “në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore” duke synuar fillimisht që të realizohen 2-3 agregime të suksesshme. Për këtë duhet të mundësohet një anketë në të gjitha bashkitë e vendit ku të përcaktohen vendet e mundshme të suksesshme për agregim. ERRU duhet të paravlerësojë tarifat e agreguara në rastet e seleksionuara për agregim.
- Të vazhdojë puna për hartimin e akteve të nevojshme nënligjore për saktësimin e procedurave të lëshimit të Akt Miratimit Higjeno Sanitar për shoqëritë UK, si dhe të Inspektimeve Higjeno Sanitare në elementët e sistemeve të furnizimit me ujë.
- Në vend të hartimit të një ligji të ri për sektorin UK të rishikohet vetëm ligji aktual nr. 8102 për kuadrin rregullator, si akt që rregullon të gjithë sektorin UK që duhet të konsistojë përgjithësisht në forcimin e rolit të ERRU si institucion i pavarur. Rishikimi duhet të përfshijë:
 - Saktësimin e kompetencave të ERRU-së si institucioni që monitoron operatorët dhe në përgjithësi sektorin UK, si dhe shmangien e mbivendosjes së kompetencave me AKUM;
 - Përfshirjen në strukturën e ERRU-së të njësisë së benchmark-ut që aktualisht ndodhet në AKUM;
 - Anëtarët e Komisionit të ERRU-së, përfshirë dhe Kryetarin të emërohen nga Kuvendi i Shqipërisë;
 - Kufizimin karakterit mjaft të përgjithshëm të kërkesave ndaj profilit të anëtarëve të komisionit, duke i saktësuar ato në përputhje me kompetencat dhe fushën e aktivitetit të institucionit të ERRU-së në sektorin e ujit;
 - Mandati i anëtarëve të komisionit të jetë 5 vjeçar në vend të atij aktual 4 vjeçar;
 - Përmirësimin e disa elementëve jo thelbësorë të pavarësisë aktuale financiare të institucionit;
 - Përmirësimin e disa aspekteve që lidhen me përmbushjen nga operatorët të disa kërkesave shtesë gjatë procesit të licencimit dhe sidomos në atë të tarifave;
 - Përmirësimin në drejtim të efektivitetit dhe zbatimit real në praktikë të neneve që lidhen me kundërvajtjet e operatorëve për shkeljet e ndryshme ku penalitetet propozohen të jenë në ngarkim të personit përgjegjës dhe jo të institucionit.

Aneksi 1 - Aplikimet e shoqërive dhe situata e licencimit për vitin 2018

Tabela 1. Aplikimet e shoqërive që kanë kaluar për vendimmarrje dhe shoqëritë që janë ende në proces

Nr.	Shoqëritë që kanë aplikuar	Kanë kaluar për vendimmarrje në KKRR					
		Mbarim afati	Ndryshim Drejtuesi ligjor	Ndryshim Drejtuesi teknik	Shtim kategori	Ndryshim zone shërbimi	Operatore te rinj
1	UK Dibër	X					
2	UK Has	X			X		
3	UK Himarë (afat)	X					
4	UK Kavajë	X					
5	UK Libohovë (afat)	X				X	
6	UK Sarandë	X				X	
7	UK Rrogozhinë	X				X	
8	UK Tropojë	X			X	X	
9	UK Gjirokastrë		X				
10	UK Tepelenë (dr.teknik)			X			
11	UK Lushnje		X				
12	U Gramsh			X			
13	UK Berat - Kuçovë			X			
14	UK Kolonje			X			
15	UK Tepelenë (dr.ligjor)		X				
16	UK Malësi e madhe				X		
17	UK Poliçan				X		
18	UK Kurbin				X		
19	UK Libohovë (zone shërbimi)						
20	UK Ura Vajgurore				X		
21	UK Vlorë					X	
22	UK Finiq						X
23	UK Dropull						X
24	UK Konispol						X
25	UK Himarë						
26	UK Tiranë						
27	UK Elbasan						
28	UK Fier						
29	UK Bulqizë						
30	UK Përmet						
31	UK Këlcyrë						
32	UK Fushë Arrëz						
33	U Selenicë						
34	UK Mallakastër						
35	UK Pustec						

Dhjetë (10) shoqëri UK që janë në proces të rinovimit të licencës

Tabela 2. *Situata e gjendjes së licencimit të shoqërive UK*

Nr.	Me licencë të vlefshme	Në proces rinovimi		Asnjëherë të pajisur me licencë
		Mbarim afati, ndryshim drejtuesi ligjor/teknik, ndryshim zone shërbimi, shoqëri e re	Me Licencë të pavlefshme dhe që nuk kanë aplikuar	
1	Sh.a. UK Gjirokastrër	Sh.a. UK Pustec	Sh.a. UK Bashkia Pukë	UK Kamëz
2	Sh.a. UK Devoll	Sh.a. UK Fier	Sh.a. U Divjakë	Sh.a. UK Klos
3	Sh.a. UK Lushnjë	Sh.a. U Bulqizë	Sh.a. UK Peqin	
4	Sh.a. UK Lezhë	Sh.a. UK Tiranë		
5	Sh.a. UK Tepelenë	Sh.a. UK Elbasan		
6	Sh.a. UK Dibër	Sh.a. U Këlcyrë		
7	Sh.a. UK Korçë	Sh.a. UK Mallakastër		
8	Sh.a. UK Durrës	Sh.a. UK Fushë Arrëz		
9	Sh.a. UK Mat	Sh.a. U Përmet		
10	Sh.a. UK Delvinë	Sh.a. U Selenicë		
11	Sh.a. UK Berat - Kuçovë			
12	Sh.a. UK Patos			
13	Sh.a. UK Kurbin			
14	Sh.a. UK Ura Vajgurore			
15	Sh.a. UK Librazhd			
16	Sh.a. U Gramsh			
17	Sh.a. UK Malësi e Madhe			
18	Sh.a. UK Kukës			
19	Sh.a. UK Vorë			
20	Sh.a. UK Kolonjë			
21	Sh.a. UK Pogradec			
22	Sh.a. UK Krujë			
23	Sh.a. UK Poliçan			
24	Sh.a. UK Vau i Dejës			
25	Sh.a. UK Belsh			
26	Sh.a. UK Maliq			
27	Sh.a. UK Cërrik			
28	Sh.a. UK Vlorë			
29	Sh.a. UK Skrapar			
30	Sh.a. UK Mirditë			
31	Sh.a. UK Roskovec			
32	Sh.a. UK Shkodër			
33	Sh.a. UK Sarandë			
34	Sh.a. UK Tropojë			
35	Sh.a. UK Rrogozhinë			
36	Sh.a. UK Libohovë			
37	Sh.a. UK Kavajë			
38	Sh.a. UK Has			
39	Sh.a. UK Himarë			
40	Sh.a. UK Dropull			
41	Sh.a. UK Konispol			
42	Sh.a. UK Finiq			

Aneksi 2 - Shoqëri që kanë aplikuar në vitin 2017 dhe janë miratuar në vitin 2018

Operatori	Shërbimi	Kategoritë e klientëve	Tarifat aktuale para propozimit për ndryshim		Tarifat sipas propozimit të operatorit			Tarifat sipas vendimit të KRRR				
			lekë/klientë /muaj	lek/m ³	lekë/klientë/ muaj	lekë/klientë /muaj	lek/m ³	lekë/klientë /muaj	lekë/klientë /muaj	lek/m ³		
			fikse	variabël	aforfe	fikse	variabël	aforfe	fikse	variabël		
Sh.a U Malësi e Madhe	ujë i pijshëm	Klientë familjarë		50	833	167	50	833	167	50		
		Klientë publikë		120		167	120		167	120		
		Klientë privat		120		167	120		167	120		
		Çezma publike			500			500				
Sh.a UK Maliq	Njësia Administrative Maliq Libonik, Pojan, Vreshtas, Pirq (Zona Fushore)	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	50	38	450	54	45	450	54	45	
			Klientë publikë	50	90		54	100		54	100	
			Klientë privat	50	95		54	105		54	105	
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		pa shërbim		50		50		54		
		Klientë publikë		pa shërbim								
		Klientë privat		pa shërbim								
	Njësia Administrative Maliq Libonik, Pirq, Gore, Moglicë (Zona Malore)	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	50	38	225	27	22.5	225	27	22.5	
			Klientë publikë	50	90		54	100		54	100	
			Klientë privat	50	95		54	105		54	105	
		ujë i ndotur	Klientë familjarë		pa shërbim		25				27	
			Klientë publikë		pa shërbim							
			Klientë privat		pa shërbim							
Sh.a U Gramsh	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	60 / pa shërbim	32 / pa shërbim		60	32		60	32		
		Klientë publikë	180 / pa shërbim	90 / pa shërbim		180	90		180	90		
		Klientë privat	150 / pa shërbim	90 / pa shërbim		150	90		150	90		
Sh.a UK Skrapar	ujë i pijshëm	Klientë familjarë		27	300	100	35	300	100	35		
		Klientë publikë		80		100	100		100	100		
		Klientë privat		95		100	110		100	110		
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		pa shërbim			10			10		
		Klientë publikë		pa shërbim			10			10		
		Klientë privat		pa shërbim			10			10		

Aneksi 3 - Aplikimet për ndryshimin e tarifave në vitin 2018

Operatori	Shërbimi	Kategoritë e klientëve	Tarifat aktuale para propozimit për ndryshim		Tarifat sipas propozimit të operatorit			Tarifat sipas vendimit të KKRR			
			lekë/klientë/muaj	lekë/m3	lekë/klientë/muaj	lekë/klientë/muaj	lekë/m3	lekë/klientë/muaj	lekë/klientë/muaj	lekë/m3	
			fikse	variabël	aforte	fikse	variabël	aforte	fikse	variabël	
Sha UK Vau Dejës	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	nuk ka patur tarifa të miratura nga ERRU			667	83	42	667	83	42
		Klientë publikë				167	120	167	120		
		Klientë privat				167	120	167	120		
	ujë i ndotur	Klientë familjarë				83	7	83	7		
		Klientë publikë					20		20		
		Klientë privat					20		20		
Sha UK Librazhd-Prrenjas	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	38 / 20	100	42 / 26	100	42 / 26				
		Klientë publikë	100 / 50	100	100 / 60	100	100 / 60				
		Klientë privat	100 / 50	100	100 / 60	100	100 / 60				
	ujë i ndotur	Klientë familjarë	13 / pa shërbim	15 / pa shërbim	15 / pa shërbim	15 / pa shërbim					
		Klientë publikë	22 / pa shërbim	25 / pa shërbim	25 / pa shërbim	25 / pa shërbim					
		Klientë privat	23 / pa shërbim	26 / pa shërbim	26 / pa shërbim	26 / pa shërbim					
Sha UK Gjirokastër	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	80 / 0	43 / 25	150 / 80	46 / 25	në proces				
		Klientë publikë	80 / 0	125 / 60	200 / 0	133 / 60					
		Klientë privat	80 / 0	130 / 60	200 / 0	138 / 60					
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		10 / pa shërbim		11 / pa shërbim					
		Klientë publikë		16 / pa shërbim		18 / pa shërbim					
		Klientë privat		16 / pa shërbim		18 / pa shërbim					
Sha UK Poliçan	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	0 / 100 / 0	37 / 44 / 0	100	50	në proces				
		Klientë publikë	0 / 200 / 0	80 / 125 / 0	200	125					
		Klientë privat	0 / 200 / 0	95 / 125 / 0	200	125					
	ujë i ndotur	Shitje e Ujit me shumicë Berat			1000	23.9					
		Shitje e Ujit me shumicë Skrapar			1000	21.41					
		Klientë familjarë		9 / 9 / 0		12.5					
Sha UK Delvinë	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	167	48	167	58	në proces				
		Klientë publikë	200	100	200	120					
		Klientë privat	200	100	200	120					
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		16.7		18					
		Klientë publikë		33.7		35					
		Klientë privat		33.7		35					
Sha UK Lushnje	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	100 / 0	58 / 60	150	65	në proces				
		Klientë publikë	200 / 0	130 / 100	200	147					
		Klientë privat	200 / 0	140 / 100	200	147					
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		17 / 0		17					
		Klientë publikë		21 / 0		22					
		Klientë privat		24 / 0		25					
Sha UK Krujë	ujë i pijshëm	Klientë familjarë		33 / 28	100	35	në proces				
		Klientë publikë		80 / 60	200	100					
		Klientë privat		80 / 80	200	120					
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		8/6		8					
		Klientë publikë		12/10		12					
		Klientë privat		12/12		12					
Sha UK Bulqizë	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	100	17	100	35	në proces				
		Klientë publikë	100	55	100	130					
		Klientë privat	100	75	100	130					
	ujë i ndotur	Klientë familjarë				12					
		Klientë publikë				18					
		Klientë privat				18					
Sha UK Vlorë	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	80/0/100	30 / 33 / 25	150 / 150 / 0	50	në proces				
		Klientë publikë	80/0/100	60 / 50 / 70	150 / 150 / 0	146					
		Klientë privat	80/0/100	80 / 70 / 75	150 / 150 / 0	100					
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		11 / 0 / 0		40 / 0 / 0					
		Klientë publikë		13 / 0 / 0		55 / 0 / 0					
		Klientë privat		13 / 0 / 0		55 / 0 / 0					
Sha UK Berat Kuçovë	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	80	30	0	50	në proces				
		Klientë publikë	80	60	0	90					
		Klientë privat	80	80	0	95					
	ujë i ndotur	Klientë familjarë	100	48 / 50	150	51					
		Klientë publikë	200	130 / 150	200	150					
		Klientë privat	200	130 / 150	200	150					
Sha UK Vorë	ujë i pijshëm	Shitje e ujit me shumicë		5.4		5.4	në proces				
		Klientë familjarë		13 / 14		14					
		Klientë publikë		22 / 24		24					
	ujë i ndotur	Klientë privat		22 / 24		24					
		Klientë familjarë	100	40	150	40					
		Klientë publikë	200	150	200	150					
Sha UK Himarë	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	200	14	200	14	në proces				
		Klientë publikë	200	14	200	14					
		Klientë privat	200	14	200	14					
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		24		24					
		Klientë publikë		24		24					
		Klientë privat		24		24					
Sha UK Pustec	ujë i pijshëm	Klientë familjarë			1,200	80	në proces				
		Klientë publikë			250	150					
		Klientë privat			250	190					
	ujë i ndotur	Klientë familjarë				18					
		Klientë publikë				50					
		Klientë privat				50					
Sha UK Tropojë	ujë i pijshëm	Klientë familjarë			200	60	në proces				
		Klientë publikë			300	100					
		Klientë privat			300	120					
	ujë i ndotur	Klientë familjarë				30					
		Klientë publikë				40					
		Klientë privat				60					
Sha UK Roskovec	ujë i pijshëm	Klientë familjarë			800	50	në proces				
		Klientë publikë			100	100					
		Klientë privat			100	100					
	ujë i ndotur	Çezma publike			50						
		Klientë familjarë			50						
		Klientë publikë									
Sha U Tropojë	ujë i pijshëm	Klientë familjarë			100	52	në proces				
		Klientë publikë			200	105					
		Klientë privat			200	125					
	ujë i ndotur	Klientë familjarë			50						
		Klientë publikë			200						
		Klientë privat			200						

Aneksi 4 - Vlera e faturës mujore (me TVSH) për klientët familjarë Viti 2018

Operatori		Fatura aktuale	Fatura e Propozuar nga Operatori	Fatura sipas Vendimit KKRR	5% i Përbalueshmërisë së Faturës Mujore*
		Faturimi Mesatar 12 m3/lidhje	Faturimi Mesatar 12 m3/lidhje	Faturimi Mesatar 12 m3/lidhje	
Sh.a U Malësi e Madhe		720	920	920	3,665
Sh.a UK Maliq	Maliq Libonik, Pojan, Vreshtas, Pirg (Zona Fushore)	607	773	778	3,553
	Maliq Libonik, Pirg, Gore, Moglicë (Zona Malore)	607	386	389	3,553
Sh.a U Gramsh	Gramsh, Kodovjat, Kushovë, Pishaj, Sult, Tunjë	533	533	533	2,891
	Kukur, Lenie, Skenderbegas, Porocan	pa shërbim			
Sh.a UK Skrapar		389	768	768	3,497
Sh.a UK Vau Dejës			805	805	3,665
Sh.a UK Librazhd-Prrenjas	Librazhd, Prrenjas	734	941	941	2,891
	Hotolisht, Lunik, Orenjë, Polis, Qendër Librazhd, Stëblevë, Qukës, Rrajcë, Stravaj	288	494	494	2,891
Sh.a UK Gjirokastër	Gjirokastër	860	1,000		3,112
	Cepo, Picar, Lazarat, Lunxhëri, Antigone, Odrie	360	456		3,112
Sh.a UK Poliçan	Poliçan	662	1,020	pa shërbim	3,497
	Vërtop	883			
	Tërpan	pa shërbim			
Sh.a UK Delvinë		1,132	1,295		2,919
Sh.a UK Lushnje	Lushnje	1,200	1,361		3,553
	Kolonjë, Fier-Shegan, Dushk / Bubullime, Allkaj, Krutje, Golem, Ballagat, Hysgjokaj, Karbunarë	864			
Sh.a UK Krujë	Krujë	590	739		3,806
	Fushë-Krujë	489			
Sh.a UK Bulqizë		365	797		2,373
Sh.a UK Vlorë	Qendër Vlorë, Vlorë	686	1,476		2,919
	Novoselë	475	900		2,919
	Orikum	480	720		2,919
	Shushicë	528	720		2,919
Sha UK Berat - Kuçovë	Berat, Kuçovë	998	1,116		3,497
	Otlak, Velabisht, Sinje, Kozare, Lumas	1,042			
	Roshnik	898			
Sh.a UK Vorë			1,711		4,398
Sh.a UK Himarë			1,536		2,919
Sh.a UK Pustec			900		3,553
Sh.a UK Roskovec			1,589		3,553

Aneksi 6 - Shoqëritë e riorganizuara dhe të licencuara sipas reformës

Nr.	Shoqëri të Licencuara sipas Reformës		
	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
1	Sh.a UK Kukës	Sh.a UK Gjirokastrë	Sh.a UK Libohovë
2	Sh.a UK Kurbin	Sh.a U Gramsh	Sh.a UK Dropull
3	Sh.a UK Vorë	Sh.a UK Korçë	Sh.a UK Konispol
4	Sh.a UK Belsh	Sh.a UK Krujë	Sh.a UK Tropojë
5	Sh.a UK Malësi e Madhe	Sh.a UK Mirditë	Sh.a UK Vlorë
6		Sh.a U Poliçan	Sh.a UK Rrogozhinë
7		Sh.a UK Berat-Kuçovë	
8		Sh.a UK Devoll	
9		Sh.a UK Maliq	
10		Sh.a UK Patos	
11		Sh.a UK Skrapar	
12		Sh.a UK Vau Dejës	
13		Sh.a UK Tepelenë	
14		Sh.a UK Delvinë	
15		Sh.a UK Lezhë	
16		Sh.a UK Pogradec	
17		Sh.a UK Shkodër	
18		Sh.a UK Cërrik	
19		Sh.a UK Roskovec	